Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

00 Numër: 175/2022
Data: 20.12.2022

http://kk.rks-gov.net/istog/
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve te Kuvendit te Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e **10-të** e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **29.12.2022, e Enjte,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00.**

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt – Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt – Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023,
7. Njoftimi me Planin e Investiv në Infrastrukturen e Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Komunën së Istogut.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027,
9. Shpallja në diskutim publik e Draft - Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026,
10. Shpallja në diskutim publik e Draft - Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023 – 2026,
11. Shpallja në diskutim publik e Draft - Planit Komunal për Integritet 2023 – 2026,
12. Shfuqizohen Vendimet 00Nr. 144/2022 i datës 31.10.2022, Vendimi 00Nr.145/2022 i datës 31.10.2022 dhe Vendimi 00Nr.146/2022 i datës 31.10.2022,
13. Shfuqizohet vendimi 00Nr. 153/2022 i datës 31.10.2022 për ndarjen e mjeteve buxhetore për përkrahjen dhe funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve".
14. Pyetje nga anëtaret përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Vërejtje :
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/ Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e nëntë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **29.11.2022,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Haki Podrimaj, LDK;
4. Faruk Kabashi, LDK;
5. Ruzhdi Metaj, LDK;
6. Faik Alushaj, LDK;
7. Arta Balaj, LDK;
8. Njomza Demaj, LDK;
9. Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;
10. Valbona Demaj, LDK;
11. Agron Gashi, AAK;
12. Arianit Selmanaj, AAK;
13. Nexhmedin Balaj, AAK;
14. Ajshe Metaj, AAK;
15. Ardita Idrizaj, AAK;
16. Negjdet Ramaj, AAK;
17. Fjolla Ukaj, AAK;
18. Florin Dreshaj, VV;
19. Niman Beqiraj, VV;
20. Qerim Rexhaj, VV,
21. Floriana Maxharraj, VV;
22. Lavdije Bujupaj, VV;
23. Andi Xhuraj, PDK;
24. Visar Haxhijaj, PDK;
25. Era Visoqi, PDK;
26. Melis Smakic, GIBI.

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: ”shembulli 1”)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e nëntë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e pesë (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023,
4. Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullores për Kategorizimin E Klubeve Sportive,
5. Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut,
6. Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba,
7. Zgjedhja e Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta ,
8. Njoftim me Planin Operativ Emergjent – Istog 2022,
9. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit tre vjeçar për banim Social në Komunën e Istogut.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtaret e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Floriana Maxharraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një propozim ta shtoj për rend dite, dhe kjo pikë të jetë në çdo mbledhje: Pyetje dhe Përgjigje.

Hedh në miratim piken e propozuar nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Floriana Maxharraj,
Kush është që këto pika pikë të hynë në rendin e ditës
Miratohet unanim
25 anëtar prezent.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pika për pyetje dhe përgjigje është praktik e zakonshme dhe nuk ka nevojë këtu me propozuar diçka, kjo është Planin e punës së Kuvendit

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim komplet rendin e ditës me këto pika
Miratohet unanim rendi i ditës për ketë mbledhje
Konstatojmë që me 25 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje mungojnë z. Veton Kurtaj i cili gjendet jashtë vendit.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.
Hedh në miratim
Miratohet unanim
Konstatohet që me 26 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 31.10.2022.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit **-** vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, planin e keni pasur secila parti e parti në Kuvend e ka pasur përfaqësuesin e tyre. A ka dikush diçka?

Florin Dreshaj - përshëndet te gjithë të pranishmit, në një muaj ku ka me pak pika të rendit te ditës ta qesim edhe Diskutimi për pronat bujqësore të K. Istogut, e dimë që janë di kund 700 hektar ara nuk e dimë se kush ose nuk po duam ta dimë se kush po i punon.

Kryesuesi i Kuvendit - i kam përcjellur këto dhe komunë e ka obligim te di për çdo pronë se çka po ndodh dhe besoj që në prill do ta kemi ketë pikë në rend dite.

Florin Dreshaj - nuk ka lidhje cilin muaj veten të jetë si njoftim për anëtaret e Kuvendit nga drejtoria e bujqësisë. Ka prona që shfrytëzohen mbi 10 vite dhe shiten, dikush i mban të uzurpuara dhe bujqit detyrohen që të paguajnë shuma të mira për ato toka.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka pasi qe nuk ka
Hedh në miratim
Miratohet unanim nga anëtaret e Kuvendit

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shpallja në diskutim publik e Projekt - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive, Rregulloren keni pasur dhe keni pasur mundësi që ta shikon nëse ka dikush diçka urdhëroni?

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, e kam shikuar me kujdes ketë Rregullore, ka pasur nevojë Istogu për një Rregullore të tillë sepse e dimë që me herët nuk janë nder mjetën në mënyrë të rregullt sepse nuk ka pasur ndonjë kategorizim i

klubeve me e dit se në çfarë garash po merr pjesë, ka pas ndarje të buxhetit që nuk i kam kuptuar unë kemi pasur herën e fundit që u bë skandaloze ajo ndarja e buxhetit për klubet sportive sepse nuk i ka pasur disa nga kriteret që janë në ketë Rregullore.
Kjo Rregullore i ka disa mangësi që po i diskutojmë pak, ndërsa në pjesën e kaluar që është ndarë buxheti është bere një keq menaxhim aty nuk janë par kriteret nuk janë par sukseset e klubeve dhe nuk i kemi motivuar sportistet në bazë të ndarjes së buxhetit ka pas klube që kanë deklaruar qe kanë deklaruar shpenzime vjetore 3mijë euro dhe ju kanë nda 3mijë euro, por ka pas klube që kanë pasur shpenzime 150mijë euro dhe ju kanë ndarë vetë 6 mijë euro përqindja ka qen e pa barabartë e ndarjeve të klubeve të caktuara dhe ne në atë formë nuk mundemi me i inkurajuar sportistët. Kur kanë një arritje kulmore mos të flasim vitin e kaluar as mirë njohje nuk u janë ndarë.
Sa i për ketë kësaj Rregullore unë e kam lexuar me kujdes mendoj që disa pjesë duhet me i shqyrtuar sepse disa pjesë janë kompetencë e ministrisë në jemi komunë dhe duhet me u nda sipas gjendjes që jemi, ndërsa këtu e kam parë së shumë pika kanë të bëjnë me ministrin me komitetin olimpik të Kosovës që ata i rregulloren këto rregullore. Duke u nisur nga pjesa e parë ku përcaktohet rangu i klubeve sportive drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me deri me datën 15 janar jua dërgon të gjitha klubeve sportive formularin përkatës për aplikim në kategorizimin e sporteve unë mendoj që komuna nuk i ka këto obligime, kjo është kompetencë e ministrisë ku ministria i licencon kategorizimin klubet sportive dhe ne thirremi pastaj në Rregulloren e ministrisë, nuk e di këto si donë me i bere komuna. Neni 6 të dërgimi i formularit për aplikim (lexon nenin) komuna nuk benë kategorizim të sportit është kompetencë e ministrisë. Ka edhe pjese tjera që janë të ministrisë këtu.
Si kriter për dhënien e këtyre subvencioneve përveç rangut që është i përcaktuar si kriter i dytë është tradita e klubit d.m.th janë dhëne piket maksimale për klubin që është formuar shumë më herët, mendoj se nuk ka lidhje kur është themeluar por sa ka suksese sepse në po ju ndajmë mjete për motivim për shpenzimet që kanë.
Nivelizimi i klubeve ka një kriter shumë të vogël prej një vendi në vendin tjetër, nga një ligë në ligen tjetër, është një përafrim i madh më pikë.
Tjetra thotë që 8 pik i merr klubi niveli i dytë, ndërsa një klub që behet kampion i merr dhjetë pikë.
Të pjesa tjetër 5B që i përcakton këto çka po i flas, Fituesi i Kupës së Kosovës 10 pikë ndërsa fituesi i ligës 10 pikë janë të barabarta që nuk duhet të jenë të barabarta.
Ndërsa e kemi finalistin ku finalisti i ka 8 pikë dhe vendi i dytë i ka 8 pikë në ligë të dytë që nuk me duket e drejt.
Pastaj dalim të 5C
E përmenda që jemi hy në kompetenca të ministrisë këtu thotë për çdo medalje në lojërat olimpike klubi merr 26 pikë po flasim për kampionat botëror klubet tona nuk marrin pjesë në kampionat botëror. Ne po dojm me e bë një Rregullore që po dojm me ju ndihmuar klubeve sportive këto këtu janë të rregulluara me Rregullore në kuadër të ministria Rregullorja për kategorizimin e sportit neni 9 i rregullon këto të gjitha, këto janë për nacionale, klubet tona nuk marrin pjesë në kampionate botërore, klubet tona marrin pjesë ne Evropë p.sh mundemi me e punuar një Rregullore që subvensionon klubet tona për pjesëmarrje në Evropianë p.sh të futbolli e ka kompeticion UEF-en Evropa Ligë, Konferenca Ligë, që nuk potencohen këtu p.sh nuk është e potencuar EHAEFI duket që nuk hyn në punë tek ne këto pjesë janë kompetent e ministris jo e komunës.

Nënkryetari i Komunës - faleminderit për komentet e sugjerimet, të subvencionet po mendoj nuk e di kontekstin e asaj qe nuk kane qen keq menaxhim por sa janë shkuar buxhetet në mënyrë adekuate të klubet sportive unë mendoj së kriteret janë të bazuara në legjislacionin në fuqi ndërsa sa i përket, se sa janë meritore këto në mënyrë se secili klub me e sit se sa është mbështetja e tyre.
Sa i përket Rregulloren nuk po e shoh dikon të grupit punues ka nevojë me u plotësuar kjo do dal në dëgjim publik dhe do të ketë ekspert që do të na ndihmojnë kështu si ti në përmirësimin dhe rregullimin e kësaj rregulloreje.
Sugjerimet e juaja do të inkorporohen në ketë Rregullore .

Agron Gashi - nënkryetar e keqkuptove pyetje për keq menaxhim, keq menaxhimi nuk është veç me i marr parat por me i nda pa kriter qik jo. Nuk janë ndarë me kriter kur një klubi ju janë ndarë 100% dhe nuk ka pas rezultate ndërsa tjetrit 5 % dhe ka pasur rezultate, tjetra mirë kish qen me kanë prizën drejtoresha ketë pasi që është propozues e kësaj rregullojë. Edhe kjo Rregullore që miratohet prape janë të mangëta sendet ashtu siç kanë qenë, bashkëqeverisje keni premtuar dyfishim të buxhetit për sportin nuk po e shohë dhe prapa klubet tona kanë me pas probleme financiare në secilën ligë.

Nënkryetari i Komunës - buxheti ka qen i trashëguar nga viti i kaluar e dinë të gjithë mundësit tona janë gogja të limituara për ketë vite mirë por jemi munduar me e bëre ma të mirën të mundshme për klubet tona.

Fjolla Ukaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi që jemi të financimi i klubeve sportive në seancën e shtatorit e kam bere një pyetje për klubin e Onix-it dhe z. Ferati ka thëne që brenda jave do ta marrim një përgjigje, tash janë 9 apo 10 javë e klubi nuk e ka një përgjigje është kërkesa e katërt e cila e kanë bëre klubi me 4 tetor, pjesa kadastrale të cilën e kanë lypur është masë postes ka donator të shumtë që po presin me investuar aty. As donatoret nuk presin një kohë të pa caktuar ndërsa e dimë që klubi paguan fushën në Vitemeric për me i bere stërvitjet e tyre. Kërkoj një përgjigje së kur do të ndahet ajo pronë për ketë klub besoj që ketë përgjigje dikush mund të ma jap?

Agon Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kryetari dhe drejtori i zhvillimit ekonomik janë në kontakte direkt me donatorin e tyre për investime ideja është që me e marr një pronë që është në menaxhim të AKP-së dhe më e diskutuar që komuna më AKP-në me e bere një ndërrim pronash dhe me e marr atë pjesë kulmi, jemi duke i parë mundësit bashkërisht, nuk është çështje e neglizhencës por janë duke punuar të gjendët një zgjidhje bashkarisht.

Fjolla Ukaj - certifikata parcela të cilën kanë ber kërkese klubi është pronë komunale nuk është e AKP- së, po flas për pronën komunale e cila është pas postes.

Florim Dreahaj - LVV tani për tani e përkrah ketë Rregullore edhe pse ka shumë mangësi drejtoresha apo dikush nga grupi punuese nuk janë prezent, po e shohë mungesë serioziteti nga drejtoresha kur e ka caktuar piken e rendit të ditës është dashur të jetë këtu. Shpresoj që do të konsultoheni prape me ligjin që të mos kthehet nga MAPL-ja.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka,
Hedh në votim

Miratohet me 22 vota për dhe 1 kundër
Të pranishëm 23 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut, edhe ketë rregullore e keni pasur dhe keni mundur ta shikoni nëse ka dikush diçka rreth saj urdhëroni?

Ajshe Metaj - a mendoni që kjo është në harmoni me ligjin sepse në mandatin e kaluar ne na kemi mbajtur bashke me gratë aktivitete për zgjedhjen e këshillave lokale të gjitha procedurat i kemi përfunduar me syri vizion bashkarish me kolegët këtu e gjithë puna ka përfunduar por në fund na u është thënë se nuk është në harmoni me ligjin, dhe gjithë aj mund i yni shkoj kotë cila pikë nuk është në harmoni me ligjin, sa është punuar para se me u nis formimi i këshillave lokale, edhe si do të shkoj sepse nuk është e lehtë me funksionuar këshillat lokale. A e kini planifikuar pagesën e tyre, a e keni menduar anën pozitive për qytetaret.

Valbona Demaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, ne kemi mbajtur takime për këto këshilla të fshatrave por na u është thëne se për shkak të një kodi buxhetor nuk ka mundësi komuna ti paguaj kryetarët e këtyre këshillave një pagës simbolike që bëhet.

Haki Podrimaj - përshëndetje për të gjithë mirë është që na ka ardhur kjo Rregullore e kemi pasur në vitin 2012 por deri me sot nuk është jetësuar pajtona me koleget problemi është financimi mirë po këtu në ketë Rregullore neni 12 dhe 13 e ka sqaruar financimin, kjo do të dal në diskutim publik dhe do të vijë prape dhe aty do të i shtjellojmë se si do të kompensohen këta këshilla lokale. Sepse pa kompensim nuk ka efekt.

Ajshe Metaj - e sqaruam pse u benë ato aktivitete pos që ka pasur probleme ekonomike, ajo ka qen edhe jo në harmoni me ligjin, nga zyra ligjore është thëne kjo.

Florin Dreshaj - duke e ditur rendësin e këshillave te fshatrave LVV e përkrah që të dal në diskutim publik dhe pastaj e diskutojmë.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?
Hedh në votim.
Miratohet unanim Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut,
Konstatohet që me 23 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e gjatë Shpallja në diskutim publik e Projekt – Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba, edhe ketë rregullore e keni pasur dhe keni mundur ta shikoni nëse ka dikush diçka rreth saj urdhëroni?

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z . Genc Ademaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Projekt – Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba.

Florin Dreshaj – ne nga LVV kishim dashtë që të neni 15 lirimi nga pagesat dhe taksat, të shtohet edhe familjaret e veteranëve të luftës.

Kryesuesi i Kuvendit – duhet ta shikojmë me ligj a na lejohet a jo.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka, pasi që diskutime tjerët nuk keni.
Hedh në votim
Miratohet unanim nga anëtaret e Kuvendit të Komunës.
Konstatohet që me 21 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë në piken tjetër Zgjedhja e Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, ky komitet është i propozuar nga drejtoria e administratës a ka dikush diçka rreth tij. Me konkurs do të zgjidhet dhe ky komitet.

Ajshe Metaj – dua të diskutoj për komitetin që është formuar mandatin e kaluar komiteti për arsim nuk e di sa kanë funksionuar nuk e di kujt i kanë dhen llogari vetëm ne si Kuvend për këto komitete nuk ka pasur kur far transparence, as sa mbledhje janë mbajtur, rezultatet e arritura apo çka ka sjell ajo iniciativ me qellim që në fund me e pas një rezultat. Këto komitete letë zgjidhen por dhe letë monitorohen nga dikush dhe të bëjnë raportime.

Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, ndoshta do të ishte me mirë me thënë themelimi i komitetit sepse ky komitet nuk ekziston, se në bazë të kësaj po i bien që ky është dhe ne po duhet vetëm me i rizgjedhur personat.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron procedurat.

Haki Podrimaj – ne jemi për zgjedhjes së këtij komiteti.

Ajshe Metaj edhe ne jemi për zgjedhjes së këtij komiteti.

Florin Dreshaj – edhe LVV është pro. Vetëm deshta edhe një here qatë shqetësim se kur kryesuesi thotë po e shpalli në diskutim pse mos me pasur diskutim?

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike?

Hedh në votim,
Miratohet unanim nga anëtaret e Kuvendit të Komunës.
Konstatohet që me 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken tjetër Njoftim me Planin Operativ Emergjent – Istog 2022,

Shef i sektorit për emergjencave, z. Skender Hasangjekaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Njoftim me Planin Operativ Emergjent – Istog 2022,

Florin Dreshaj – ti ndërrohet emërtimi Plani operativ 30 nëntor edhe dhjetor sepse viti kalendarik veç se shkoj.

Skender Hasangjekaj – po besoj se të gjithë po e shihni se pani është nga viti 2017, tani në vitin 2022 e kemi ndryshuar për ata edhe u qitë në mbledhje. Në faqen 5 e shihni regjistrimi i ndryshimeve tani çdo ndryshim do të ceket në ketë faqe nga nënshkrim dhe publikimi i këtij Plani, në ketë plan do të plotësohen ndryshimet dh do të mbetet i përhershëm në komunën e Istogut.

Florin Dreshaj – nuk e thash që nuk po pajtona me përmbajtjen vetëm me vitet a është 22 apo 23, është tepër vonë për vitin 2022 për me fol për një planë.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka?
Konstatohet që janë 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në sall.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit tre vjeçar për banim Social në Komunën e Istogut.

Nënkryetari i Komunës - benë prezantimin dhe sqarimin e Planit tre vjeçar për banim Social në Komunën e Istogut.

Ajshe Metaj – a ka pasur ndonjë iniciativ apo është ndërtuar ndonjë banës për banim social. A po mendohet që banesa për banim social të jetë falas për ata njerëz të cilët nuk kanë paga. Në material e pash me u ndërtuar banesa por me u dhen me qira, ata qytetarë që nuk kanë mundësin me paguar të ketë lehtësime apo të ketë zgjidhje edhe për qytetaret e tjerë.

Nënkryetari i Komunës – në ketë plan me legjislacionin në fuqi rregullohen familjet që nuk kanë banës apo pronësi individuale dhe ketë kategori ky grup e synon. Përveç se

ky planë e parasheh ndërtimin e një banese kolektive këtu parashihen edhe pagesat e qirave.

Drejtoresha e Mirëqenës Sociale, znj. Merita Muzlijaj Bytyçi - përshëndet të gjithë të pranishmit, Benë sqarimin e gjendjes së banimit social të deri tanishëm, po ashtu sqaron rreth ndërtimit të ri të banimit social siç parashihe edhe në Planin për banim social.

Niman Beqiraj - pyetje objektet qe kanë qenë para luftës dhe që janë ende a ka në plan renovimin e atyre banesave.
Banesat janë në gjendje shumë të keqe e tani në këto ditë me shi kam vizituar disa familje. Ato banesa kanë probleme edhe me kulmin është në gjendje të keqe dhe mundet dita ditës me u rrezuar me pas pasoja. A keni paraparë mirëmbajtjen apo rregullimin e tyre?

Fjolla Ukaj - ju drejtoresh i kini vizituar familjet që janë strehuese, sa do ta këto pagesën mujore.

Drejtoresha e Mirëqenës Sociale, znj. Merita Muzlijaj Bytyçi - aktualisht Komuna e Istogut ka dy familje strehuese, i mbështesim në forma të ndryshme dhe me një shumë simbolike i subvencionojmë.

Fjolla Ukaj - njëra nga familjet ka potencuar se që 6 muaj nuk ka morr pagesën nga komuna.

Drejtoresha e Mirëqenës Sociale, znj. Merita Muzlijaj Bytyçi - jemi të njoftuar me rastin ka ndodhur një gabim teknik kam biseduar personalisht dhe shumë shpejt do të zgjidhet problemi për ta, familja do ti marr të gjitha mjetet që ju kanë ndaluar retroaktiv.

Nënkryetari i Komunës - kam pasur është unë personalisht familje që kanë ardhur pas reshjeve të fundit dhe kemi biseduar për gjendjen e objektit por sa kam informacione nuk menaxhon komuna me këto objekte. Me rendësi është që të gjendët një zgjidhje.

Hajrush Shoshi - disa vërejtje rreth këtij plani e përgëzoj komisionin qe janë marr me ketë plan dhe besoj që do të miratohet por të pjesa e popullsisë ku shkrinë kemi të dhënat mbi statistikat e komunës se Istogut nga prilli 2011, ndërsa me poshtë e kemi nga komunitetet të cilët jetojnë në komunën e Istogut të dhënat nga zyra për çështje të komuniteteve në kuadër të zyrës së kryeministrit, këto të dhëna për mendimin tim është dashur të fshihen është të gjitha përqindjet të mbesin sipas statistikave të vitit 2011, sepse këtu i kemi 90.1% shqiptar ndërsa në regjistrimet janë 92.02% shqiptarisë i kemi 5.44% egjiptian, ndërsa bazë regjistrimit i kemi 3.95% prandaj kjo tabelë sipas mendimit tim duhet të rregullohet edhe të behet në bazë të regjistrimit të popullsisë.
Tabela përqindja e popullsisë së njerëzve prej moshës 15 vjeç e lartë. Shkalla e arsimimit në komunën e Istogut kemi vetëm një përqindje, të pa arsimuar janë 0.51% me pak së filloret 1 deri në tri vite janë 2.24% janë mirë po në tabele shkruan burim është drejtoria e Arsimit në komunën e Istogut faqe 35.
Kisha dashur ta di se nuk e kemi të dhënën numrin nga cili është marr kjo përqindje, nuk mund të nxjerrësh as një përqindje nëse nuk e ki numrin bazë nga sa banor është nxjerre edhe në cilën kohë janë nxjerr këto rezultate sepse janë shënime bukur të rëndësishme dhe ish dashur të jen të sakta.

Askund nuk përmenden donatoret qe nga paslufta kemi shumë donacione për familjet nga donator privat është mirë të figurojnë dhe të falënderohen ata donator në ketë Planë.

Kryesuesi i Kuvendit - pika e dytë çka po propozon ti me bë të te dhënat e të arsimuarve në K. Istog.

Hajruah Shoshi - pata pyetje për drejtorin se nga kanë ardhur këto shënime ku është burimi i të dhënave ?

Nënkryetari i Komunës - ky Plan na ka marrë kogja një kohë në mbledhjen e statistikave dhe materialit. Ky plan ka statistika për familjet me nevojë, dhe pjesën tjera se çka është paraparë e nevojshme. Sa i përket komiteteve ne kemi përdorur burimin e informatës nga zyra e kryeministrit pasi që këto statistika janë të publikuara. Çka do që miratohet në kuvend ne jemi të gatshëm ta korpurojm në Planë.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, këto statistika janë marr 2014- 2015, dhe në bazë këtyre statistikave që janë dal këto përqindje ne si DKA jemi duke u marr me përgatitje e Planit Zhvillimor të DKA-së, me komision 2022 do gi kemi statistikat dhe 2023 do të dalim me një raport.

Hajrush Shoshi - pasi që thatë që statistikat janë 2014- 2015 vetëm ti referohen ati dokumenti dhe nga kush janë , numrin e banorëve të ceket.

Nimon Beqiraj - pasi që nënkryetari tha jemi profesional, dua që të jemi me shumë profesional, deri të ato të rrjedhjeve të gabimeve teknike të përmirësohet pika 6 profili i komunës ku thotë së Istogu si vend banim u formua në shekullin e mesëm nuk e di në fakt cili është shekulli i mesëm, ndoshta ju ka përvjedhur si gabim teknik por dua ta di cili është shekulli i mesëm.

Nënkryetari i komunës - nuk e thash së Plani është perfekt, krejt këto vërejtje që i kin ne do ti marrim dhe do ti mbajmë shënime për to dhe do ti inkorporojmë ne Planë. Grupi punues do të mblidhemi edhe një here dhe do të punojmë dhe këto vërejtje ti rregullojmë.

Ajshe Metaj - furnizimi i ujit është parësorë kemi ujë por jo mjaftueshëm ka nevojë për riparime dhe gjetje të burimeve të tjera. Sa kam informacion komuna nuk ka ngrohje qendrore të qytetit, a keni menduar ndonjë alternativ për ngrohjen e këtyre banesave te reja , sepse problemi me ngrohje janë është nëpër familje. Çështja e migrimit të popullsisë a kini statistika sa kanë imigruar në komunën tonë? Ne kemi një indikatorin i cili në fakt po na jep një tregues që nxënësit po mungojnë për shkak të migrimit.

Nënkryetari i Komunës - migrimi është trend që po ndodh në gjithë Kosovën, nuk po mund ta ndalojmë ne po mundohem të bëjmë kushte për qytetaret.

Kryesueai i Kuvendit - Nimani dha një rekomandim të përmirësohen gabimet teknike dhe Hajrushi që çështje profesionale.
Hedh në miratim rekomandimin e Hajruahit të rregullohen dhe plotësohen burimi statistikat 2011
Miratohet me 20 vota për unanim

20 anëtar prezent.

Agron Gashi - këto të dhënat e fundit janë dhen kjo e Hajrushit e sjell edhe një defekt tjeter se që 10 vite nuk paska as një statistikat për arsimin në Istog. Ndoshta Naimi sivjet fillon me bëre.

Hajrush Shoshi - thash të sillet dokumenti se nga janë marr këto statistika sepse duhet të jetë një komision që ka kosto dhe të behet një platformë të regjistrohen qytetaret.

Niman Beqiraj - Agjencia e Statistikave është institucioni bartë i statistikave të Kosovës e cila vepron në kuadër të zyrës së kryeministrit, nëse të dhënat janë marr nga zyra e kryeministrit ato janë të dhënat me të reja. Atomistikat nga viti 2011 kanë ndryshuar ne e dimi se kanë dal jashtë vendit nga numri i votuesve.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike?
Atëherë e hedh në votim,
Miratohet unanim nga anëtaret e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që me 19 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë piken e radhës pyetje dhe përgjigje. Nëse kini pyetje urdhëroni.

Lavdije Bujupaj - përshëndetje për të gjithë, fatkeqësitë natyrore, demet, Nënkryetar sa keni mundësi që qytetaret e komunës ton në të ardhmen të jenë sa me pakë të rrezikuara nga vërshimet pra sa është mundësia juaj si ekzekutiv të veproni tek Bollovani ndërtimin e disa tendave digave mbrojtëse se jo vetëm unë por shumë qytetar të komunës ton shpresoj dhe besojnë që në mënyrë te evidentohet fatkeqësitë e vërshime, janë që të ngritën disa tenda të mëdha në mbrojtje të vërshimeve nga Bollovani. Sa kini mundësin si komunë me ndërhy aty?

Arta Balaj - pershendetje për të gjithë, pyetje për drejtorin e bujqësisë, qytetarët e frashtit Lluga duan ta din se kur do të vazhdohet puna në kanalin e ujitjes?

Nimon Beqiraj - pyetje për drejtorin Abedin Kabashi, në fshatin Vrelle mulliri i Bicaj tash e një vite është i pa pastrua pas rrëzimit aksidental te murit aty afër ende nuk janë pastruar mbetjet edhe pas shumë kërkesave që i kanë pasur fshataret aty është kalimi dhe puna e mullirit janë të vështirësuara. Po ashtu ju ka pamundësuar është banimi familjes së cilës ka banuar aty më herët?
Pyetja 2 fshati Cerrcë rruga Livadhet e Buta është kërkese nga banoret që të shtrohet rruga janë rreth 15 shtëpi, dhe mund të shtohet edhe kjo rrugë ?
Pyetja 3 për drejtoreshën e kulturës po nuk është këtu, e kemi ber një pyetje është me herët për sallën e sportit në Vrellë kemi dashur ta dimi se çka po ndodh më të se ka thëne pas dy javësh do fillojnë punimet aty dhe kanë shkuar tre muaj e ende nuk kanë filluar, ndërsa tash është kthyer në një rrezik që është dashur të ishte sallë e sportit dhe dëfrimit për Rini.

Fjolla Ukaj - pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, beso që është i njoftuar pjesa nga shkolla Trepqa pas Onix-it nuk ka ndriçim. Tash dimri fillojnë reshjet e bores ka shumë qenë endacak fëmijët të cilët ecin kam janë të rrezikuar. A keni menduar dhe kur o në plan ndriçimi i kësaj rruge?
Duhet të jetë prioritet kryesor sepse po rrezikohet jeta e nxënësve dhe prindërve.

Ajshe Metaj - ne profesorët që nga viti 2019 i kemi ber sisa padi për shkak të shujtave dhe pagesës së udhëtimit, përgjigja e komunës ka qene se nuk ka mjete financiare, kështu që ne jemi detyruar ti vazhdojmë procedurat punët kanë ngecur diçka fokus i pagesës së tyre ka qenë 400mijë euro, kisha dashur që Osmon Sadikaj me na jep një përgjigje. E dua një përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit - Ajshe po ta dhë një përgjigje nga ajo se çfarë di unë, kjo krejt çka i ka paraparë kontrata kolektive e kemi par së ministrja e ka anuluar deri me 1 dhjetor.
Por këto padi siç i ka proceduar Gjykata Komuna ju ka përgjigjur asaj disa shkolla i kanë marr shumë me herët disa tani por të gjithë do ti marrin.

Ajshe Metaj - çështja e kësaj është ngritur sisa here edhe para këtij mandati, kërkoj që Osmon Sadikaj të jetë në mbledhje dhe të ma sqaroj punën e 400mijë euro. Faleminderit për përpjekjen tuaj.

Hajrush Shoshi - ne si kuvend 400 mijë euro e kemi aprovuar dhe i kemi qu nëpër projekte, prandaj përgjigja është e dhënë.

Naim Behlulaj - sqaron , profe kërkesa juaj është legjitime që ju takon me kontratën kolektive, pas takimeve që i kemi pasur me ministrin e Arsimit prape ka me pas mjete që kanë me shkuar suficit por nuk po kemi të drejt ligjore me i paguar shujtat që e kemi ngrit ketë çështje ministria e Arsimit dhe e Financave arsyetohen që nuk kini kod të veçantë për shujta.
Ndërsa sa i përket kërkesës kam diskutuar me Avokatin e komunës dhe ka mbetur që të diskutoj me gjyqtarin që të vine lendet para 24 nëntorit. Pas kësaj date s'kemi të drejt të kryejmë pagesa.

Hajrush Shoshi - një sqarim, nuk mundet komuna absolutisht as një Vendim të gjykatës me e ekzekutuar atë e benë vetëm Ministria e Financave Thesari.

Valbone Demaj - dua ta përgëzoj Kryetarin me ekipin e tije për menaxhimin e situatës së vërshimeve. Vetëm dua ta di a është formuar komisioni për daljen në tereni me e verifikuar sa ka dëme dhe kushtet janë të dëmtuarit? Dhe a ka mundësi komuna me ju dal në ndihëm këtyre familjeve që kanë pasur dëme gjate këtyre vërshimeve?

Nënkryetari i Komunës - përgjigjet, Lavdie, dëmet dhe çështja e Bollovanit, ne si ekzekutivi ju dhe të gjithë qytetarëve kanë qenë në një farë forme të mobilizuar duke dhen kontributin e tyre në animin e vërshimeve aq sa kemi mundur, qoftë nga Bolluvani qoftë nga lumenjtë tjerë të cilët i kanë prekur shumë ekonomi familjare shumë biznese e qytetarë në përgjithësi kanë shkaktuar dëme ne si komision kemi formuar shtabin emergjent dhe kemi qenë të gatshëm dhe pran qytetarëve deri në orët e vona siç e keni par edhe ju përmes mediave apo platformave tjera. Fatmirësisht nuk kemi pasur dëme

në aspektin humanë njerëzor por vetëm dëme materiale. Komisioni është formuar dhe çdo ditë është në teren duke evidentuar ato dëme, kemi edhe dëme në bujqësi nga fermerët.
Ne ai komunë me mundësit dhe buxhetin se e kemi është e pa mundur me i mbuluar të gjitha ato dëme, mirë po kërkesat do ti rekomandojmë në qeveri dhe bashkëpunim me nivelin qendror dhe qeverinë e Republikës së Kosovës do të mundohemi tu dalim në ndihmë bizneseve fermerëve dhe të gjithë qytetarëve që janë prekur nga përshkimet.
Ndërsa sa i përket Bollovanit dhe lumenjve tjerë ne si komune do të jemi koshient që të ndërmarrim masa që mos të na përsëriten vërshime të tilla. Mirë po devijimi e lumenjve nuk kemi mundësin me e bë por me krijuar kushte apo pengesa në mënyrë që ato vërshime mos të bartin siç është zhavorri etj. Edhe të lumenjtë duhet të krijohen shtretër të mirëfilltë që mos të mund të devijojnë siç kanë devijuar.

Abedin Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, sa i përket pyetjes së Nimanit, muri në fshatin Vrellë, si drejtori kemi qen në vend të ngjarjes kemi raportin e kemi edhe raportin e Policisë po ashtu instituti gjeologjik, nuk kemi pasur as një mundësi me ndërhyn aty sepse prona është në një rrezikshmëri kogja të madhe aty është shtëpia dhe as kur nuk po mund ta marr atë përgjegjësi aty, jemi në kontakt të ngushtë me agjencinë emergjentë me institutin gjeologji, dhe ra shikojmë si do ja bëjmë.
pyetje tjetër rruga në Cerrcë, kohë pas kohe aty kemi intervenuar me zhavor kohen e fundit shkak pse nuk kemi intervenuar është kanalizimi i asaj rruge Livadhet e Buta.
Pyetja nga Fjolla, ndriçimi nga shkolla deri të furra. Vitin tjetër është i planifikuar ndriçimi në atë pjesë.
Valbona për komisione për verifikim te dëmeve nga vërshimet. I kemi formuar dy komisione nga drejtoria janë në teren duke punuar.
Kisha dashur diçka për ju asamblistët, shqetësimet ose problemet që i kini mos pritoni me i adresuar së ndonjëherë edhe informatat po na mungojnë, i kemi disa asambleistet që nuk printojnë vine na informojnë na thërrasin kështu se kisha pas dëshirë është disa tjerë të bëhen me akti të na kontaktojnë.

Astrit Hajrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, znj. Balaj pyetje për kanalin e ujitjes në Lluga lagja Balaj. Aty është përfunduar një pjesë e kanalit të ujitjes ndërsa pjesa tjetër ka mbetur pa u përfunduar dhe kemi pasur kërkesa nga kompania e kontraktuar që të rritet vlera e kontratës për arsye të ngritjes së çmimeve gjë që nuk po varet nga ne. Ne jemi munduar dhe kemi shterur të gjitha mundësit që kompania të vazhdoj punimet por ata nuk kanë pranuar dhe jemi detyruat të ndërpresim kontratën.
Dua të jap një përgjigje edhe z. Florin Dreshaj për parcelat në bujqësi të cilat i kemi rrethe 648 hektar pronë bujqësore dhe afati i tyre i fundit është 31 dhjetori për publikimin e këtyre pronave për vitin vius.
A po stershiten këto prona nuk kam ndonjë informacion, po besoj që nuk ki as ti, nëse ki adresojnë këto individ kushdo që të jetë. Në mbledhjen e ardhshme kemi te diskutojmë për prona.

Florin Dreshaj - pyeti a ki informacion, jo veç unë por të gjithë e dinë se kush është duke i shfrytëzuar e në qoftë së drejtori nuk e dinë është shumë keq drejtor nuk e di a e din pse je aty kur se din kush po ti punon arat tua, ti je përgjegjës për to.
Pyetje:

Ne në gjimnazin Haxhi Zeka e paguajmi një sigurim aj sigurim paguhet nga nxënësit, e kanë kerkuar vetë këshilli i nxënësve të shkollës, por ketë vitë kemi pasur problem me i mbledh të hollat, a kish pasur mundësi që komuna me e marr përsipër pagesën e tije?

Naim Behlulaj - për momentin nuk e kemi në planifikim, por nëse do kemi mundësi do ta paguajma.

Lavdije Bujupaj - kërkesë tash kanë kaluar një vite që jemi në Kuvend dhe ende nuk e kemi zgjedhur kryetaren e grupit të grave asamblistë, nëse me lejohet propozoj që kryetare e GGA- së të jetë znj. Valbona Demaj, arsyet janë të shumta e kemi kolege të gjithë e dimë që punon mirë, është e përkushtuar shumë aktive dhe me përvojë, shpresoj që të me përkrahni.

Kryesuesi i Kuvendit - nga kryesuesi do ta kini përkrahjen gjithmonë, pajtohemi punoni dhe veproni sa të mundeni.

Si kryesuesi i Kuvendit kamë vërejtje për an të cilët pa arsye nuk njëjtën deri në fund të mbledhjes për ti përfaqësuar interesat e qytetarëve. Ne jemi këtu që të kontribuojmë për qytetaret tanë se ata na kanë votuar she ne jemi këtu si përfaqësues të qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit – A ka ndonjë pyetje apo shqetësim tjetër?
Pasi që nuk ka këtu përfundojnë pikat e rendit të ditës për mbledhjen e sotme.
Konstatohet që 15 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhëne,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:45

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

REPUBLIKA E KOSOVËS●REPUBLIKA KOSOVA●REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT●OPŠTINA ISTOK●MUNICIPALITY OF ISTOG

DRAFT - Plani i Veprimit për Transparencë

2023-2026

Qeverisja e mirë nënkupton pjesëmarrje qytetare dhe vendimmarrje transparente. Komuna e Istogut kujdeset maksimalisht që të përmbushë këto standarde, e vetëdijshme se vendimmarrja transparente e rrit besueshmërinë e publikut te qeverisja lokale.

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi ***h*** të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), bazuar në Rregulloren për Transparencë të Komunës së Istogut, të miratuar në Kuvendin Komunal 01 Nr.337 dt. 27.11.2014, nenit 15 pika 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Kryetari i Komunës së Istogut, Ilir Ferati , i propozon Kuvendit të Komunës të miratojë këtë:

PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

2023-2026

Hapat konkretë, që Kuvendi i Komunës së Istogut do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së Planit të Veprimit dhe rekomandimeve të ekzekutivit të Komunës përfshijnë objektivat si në vijim:

1. **Objektivi i parë i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve tjera. Në këtë objektiv parashikohet:**

   1.1 Njoftim për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve përmes faqes zyrtare, rrjetet sociale në medie të shkruara dhe elektronike, mbi vendin e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.

   1.2 Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit për të publikuar njoftimin, së paku shtatë (7) ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

   1.3 Mbledhjet e Kuvendit do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorim nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe kanalit të YouTube.

   1.4 Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal shtatë (7) ditë pune para mbledhjes së rregullt të Kuvendit.

2. **Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.**

   2.1 Njoftim për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës përmes web-faqes zyrtare në medie të shkruara/elektronike, rrjetet sociale mbi vendin e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.

   2.2. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit për të publikuar njoftimin së paku tre (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

   2.3 Mbledhjet e jashtëzakonshme do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorin nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe kanalit të YouTube.

   2.4 Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal tre (3) ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

3. **Konsultimi me publikun, ku parashikohet të këtë:**

3.1 konsultimi për buxhet,

3.2 konsultimi për zhvillim ekonomik lokal,

3.3. konsultimi për planifikim hapësinor,

3.4. konsultimi për investime,

3.5. konsultimi për të hyra komunale dhe

3.6. konsultimi për çështje tjera në interes të përgjithshëm.

3.7. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit së paku dy (2) javë para mbajtjes së konsultave me publikun dhe publikohet në web-faqe zyrtare të komunës, në media të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara.

4. **Takimet me publikun, ku parashikohet**:

4.1. Komuna, përkatësisht Kryetari i Komunës, do të mbajë së paku dy (2) takime me publikun gjatë vitit (njëri në fund të gjashtëmujorit të parë dhe tjetri në fund të vitit fiskal), për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilin takim mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë.

4.2. Përveç këtyre dy takimeve me qytetarë, Komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara në pikën tre (3) të këtij Plan Veprimi.

4.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i Zyrës së Kryetarit, përkatësisht nga Zyra e Informimit, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në web-faqe zyrtare të Komunës, në media, vende të frekuentuara si dhe në rrjetin social.

5. **Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ, dhe gazetarë.**

5.1. takime në formë debati me qytetarë,

5.2. takime pyetje dhe përgjigje,

5.3. intervista, konferenca për media dhe

5.4. Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në Sallën e Kuvendit të ketë takime me qytetarë.

5.5. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga shefi i kabinetit të kryetarit dy javë para, përmes Zyrës së Informimit, për njoftimin e agjendës dhe vendin e mbajtjes së takimeve.

6. E drejta e qasjes në dokumente publike.

6.1. Kërkesa për qasje në dokumente trajtohet nga secili organ i Komunës që posedon dokumentin duke mbikëqyr informatën,

6.2. Organi komunal ndihmon kërkuesin për qasje në dokumente publike aq sa është e mundshme për të identifikuar dokumentin e kërkuar dhe trajtimi bëhet në mënyrë të barabartë.

6.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyrtari i caktuar nga Organi brenda (7) ditësh dhe mund të vazhdohet deri në 15 ditë.

6.4 Njësia/zyra për Informim bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe i adreson ato tek njësia ku gjendet dokumenti/informata, dhe pas marrjes së dokumenteve/informatës, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike e dërgon të kërkuesi.

6.5 Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike dhe fillimisht i adresohet zyrtarit për shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, pastaj zyrtari në fjalë e përcjell tek organi/njësia ku është dokumenti.

7. **Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet.**

7.1. Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të trajtohen drejtpërdrejtë apo përmes kërkesave me shkrim.

7.2. Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës, brenda afatit prej 60 ditësh.

7.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit dhe i përcjellët Zyrës së Informimit për publikimin e njoftimit.

8. **Publikimin e akteve komunale.**

8.1. Të gjitha Rregulloret, Vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhet publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL.

8.2. Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në web faqen zyrtare të Komunës, pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas regjistrimit në MAPL, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi.

8.3 Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit, ndërsa publikimi i dokumenteve në nga Zyra e Informimit.

9. Freskimin e faqes zyrtare të Komunës.

9.1 Mirëmbajtja e web faqes zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ nr.01/2015.

9.2 Përgjegjësia për mirëmbajtjen e web faqes së Komunës është e Zyrës së Informimit dhe Zyrës së IT-së.

10. **Qasjen e shërbimeve për qytetarë në mënyrë transparente dhe të shpejtë.**

10.1 Lëshimi e certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi që personi është gjallë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve etj.

10.2 Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve sipas pikës 10.1 duhet të publikohen në web-faqen zyrtare ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

10.3 Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së.

11. Prokurimin transparent. **Në këtë kuadër parashikohen:**

11.1 Njoftimi për kontratë,

11.2 Njoftim për dhënien e kontratës,

11.3 Njoftim për shpallje të tenderëve,

11.4 Njoftim për anulim,

11.5 Njoftim për informata shtesë,

11.6 Njoftim për nënshkrimin e kontratës

11.7 Kontratat e nënshkruara

11.8 Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, qe po ashtu dërgon për publikim ne E-prokurim, përkatësisht në KRPP dhe në web faqe të Komunës tek linku i Prokurimit.

11.9 Secili qytetarë e ka mundësinë të hyjë në ueb faqen e KRPP-së (E-prokurimi), njoftimet-prokurimet (kërkim i avancuar) dhe ne bazë kësaj zgjidhet autoriteti dhe njoftimi për çka është i interesuar. Po ashtu edhe në web faqen zyrtare të Komunës tek linku i Prokurimit dhe të informohet për të gjitha procedurat.

12. **Procedurat e punësimit transparent për qytetarë.**

12.1 Shpallja e konkurseve,

12.2 Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,

12.3 Njoftimi për anulimin e konkursit,

12.4 Rishpallja, apo vazhdimi i konkursit,

12.5 Avancimet brenda institucionit,

12.6 Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit te shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre Zyra e Informimit.

12.7 Publikimi i të gjitha procedurave në shërbimin civil publikohen në web-faqe zyrtare të komunës, në objektin e Komunës, në media të shkruara dhe atyre elektronike. Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për shërbimin civil.

13. **Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë. Për të përmbushur këtë objektiv, plani i veprimit parashikon ndër të tjera:**

13.1 Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj., të cilët në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve.

13.2 Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit.

13.3 Përmirësime sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë për bashkëpunimin dhe qasjen e organizatave të shoqërisë civile në punimet e Kuvendit të Komunës.

13.4 Ndihma tjetër për organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

13.5 Publikimi i projekt-akteve në faqen e internetit, si dhe të relacioneve dhe propozimeve përkatëse.

14. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës.

14.1 Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetin vjetor komunal.

14.2 Caktimi i pikave të veçanta në seanca të KK-së për pyetje drejtuar ekzekutivit për çështje të caktuara me interes publik.

14.3. Përfshirja e raporteve të ndryshme të institucioneve dhe organizatave që lidhen me planin e veprimit të punës së Kuvendit.

15. Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit dhe Komunës si tërësi.

15.1 Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës.

15.2. Rritjen e kapaciteteve për shërbimin e teknologjisë së informacionit.

15.3 Sigurimin e buxhetit nga donacionet për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e KK-së etj.

16. Qytetarët do të kenë në shërbim edhe e-mailin zyrtar të Komunës (info.istog@rks-gov.net) ku qytetarët mund të shkruajnë dhe të adresojnë pyetje secilit punonjës brenda Komunës.

17. Plani i transparencës është për tre (3) vite, sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018, por i njëjti mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.

Kryetari i Komunës
Ilir Ferati

Objektivat e Planit të Veprimit për Transparencë

	Objektivat e planit të veprimit të transparencës	Aktivitet e planit të transparencës	Njësia / apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës	Vendi i mbajtjes të aktivitetve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunale
1	**Mbledhjet e rregullta të**	Njoftimi për mbledhje të	Sekretaria e Kuvendit përmes	Salla e Kuvendit	Njoftimi për mbledhjet e

	Kuvendit Komunale dhe të Komiteteve të tjera	rregullta të Kuvendit Komunal dhe komiteteve bëhet në: Ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në rrjete sociale	njësisë/zyrës për Informim, njofton qytetarët së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes	Komunal.	rregullta te Kuvendit Komunal është 7 ditë para mbajtjes.
2	**Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal**	Njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal bëhet në: Ueb faqe zyrtare, ne media te shkruar dhe elektronike, hapësira administrative te Komunës, në rrjete sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrës për Informim bënë njoftimin për mbledhje.	Salla e Kuvendit Komunal.	Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme te Kuvendit Komunal është 3 ditë para mbledhjes.
3	**Konsultimet me publikun**	Komuna organizon Konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve: Konsultimet për buxhet dhe dëgjime për planifikim buxhetor, konsultimet për zhvillimin ekonomik lokal, konsultimet për investimet dhe	Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrës për Informim, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik. Njoftimi bëhet: Në ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrejte sociale.	Në sallë e Kuvendit Komunal, ose në objekte me hapësirat të mjaftuesh me brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.	Njoftim për konsulta me publikun, publikohen dy javë para seancës së konsultimeve.

		konsultimet për çështje të tjera në interes të përgjithësi.			
4	**Takimet me publikun**	Komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. Përveç dy takimeve publike, Komuna dhe Kuvendi mund të shqyrtoi mundësin për të mbajtur takime shtesë, dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të	Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrtarit për Informimi me qytetar njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik, Njoftimi bëhet: Në ueb faqes zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrejte sociale	Në sallën e Kuvendit të Komunës, ose ne ndonjë vend brenda territorit të Komunës me pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.	Njoftim për takimet me publikun , publikohen dy javë para mbledhjes së konsultimeve.

		përgjithshëm.			
5	**Takime dhe Intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ-të dhe gazetare**	Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencav e të tij duhet të realizojë takime me qytetarët. Takimet në formë debati me qytetarët , takime me pyetje dhe përgjigje. Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në Sallën e Kuvendit të këtë takime me qytetarët.	Shefi i kabinetit të kryetarit përmes Zyrës së Informimit bënë njoftimin para mbajtjes së takimit dhe e publikon në web faqe, në rrjete sociale, në media të shkruara dhe elektronike.	Në sallë e Kuvendit Komunal, në sallën e mbledhjeve ose në objekte me hapësira të mjaftuesh me.	Njoftimi për qytetarët lidhur me takimet dhe intervista me kryetarin e komunës duhet të bëhet dy javë para takimit apo intervistës, në raste të veçanta edhe brenda ditës.
6	**E drejta e qasjes në dokumente publike**	Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin e mbikëqyrë informatën. Institucioni publik (Komuna) ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë , të identifikojë dokumentin e	Zyrtari për qasje në dokumente publike bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumentet publike dhe i adreson tek njësia ku është dokumenti dhe brenda afatit ligjor prej 7 ditësh i kthen përgjigje palës kërkuese, pas marrjes së dokumentit/infor matës nga njësia prodhuese e dokumentit/infor matës në	Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtroh en në mënyrë të drejtpërdre jtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike .	Organet e Komunës (njësia që posedon dokumentin) obligohet që brenda shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të kthej përgjigje njësisë kërkuese, ndërsa për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm njofton kërkuesin me shkrim dhe informon

		kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen në mënyrë të barabartë.	pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.		kërkuesin për të drejtën e tij të ankesës. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, sipas Ligjit për Qasje.
7	**Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet**	Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtroi kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe peticion, për çështje që janë përgjegjës organet e Komunës. Investimet në interes të përgjithshëm, ku participimi është bashkë me qytetarët. Mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm.	Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose Zyra për Informim, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.	Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe peticioni parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim.	Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
8	**Publikimi i akteve komunale**	Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet	Drejtoritë që posedojnë dokumentacionin përmes zyrtarit për informim	Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumente	Aktet nënligjore të komunave publikohet në faqe zyrtare

		tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit te ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	publik bënë publikimin e tyre në ueb faqen e komunës	ve tjera publike duhet të publikohet në ueb faqe të Komunës, media të shkruara dhe elektronike, apo në rrjete sociale.	15 ditë pas regjistrimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa dokumentet tjera publike publikohen pas hyrjes në fuqi.
9	**Freskimi i web faqes zyrtare të Komunës**	Web-faqja zyrtare e Komunës bëhet sipas Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për web faqet e Institucioneve Publike.	Obligohen Zyra e Informimit dhe e IT-së që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ.	Web faqja e institucionit publik gjithashtu duhet të ketë: Hartën e faqes, lidhja (linku) me portalin shtetëror dhe ueb faqet e institucioneve vartëse dhe lidhjen (linkun) me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe linçeve të tjera që janë ne	Mirëmbajtja ueb-faqen zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015.

				interes të përgjithshëm.	
10	**Qasja e Shërbimeve për qytetarët në mënyrë transparente dhe të shpejtë**	Certifikata të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi për personin që është gjallë, dëshmi për vdekjen, e cila u shërben qytetarëve për trashëgimi, vërtetimin që është mbajtës i familjes, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve, regjistrimi i kurorëzimeve nga bota e jashtme për të gjitha komunat e Kosovës, si dhe certifikatat mbi bashkësitë familjare.	Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së dhe Zyra e Informimit.	Formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet publikuar në web faqen zyrtare, ku qytetari ta ketë qasjen e lehtë.	Ne web faqe zyrtare te linku i shërbimeve për qytetarët, publikohen edhe procedura për shërbime dhe afate e caktuar për kryerjen e shërbimeve.
11	**Prokurimi Transparent**	Njoftim për dhënien e kontratës, Njoftim për anulim Njoftimi për vazhdimin e afatit	Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, e cila i dërgon këto njoftime për publikim ne E-	Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen në web e KRPP-së dhe në web faqen e	Të gjitha njoftimet e prokurimit bëhen publike sipas afateve ligjore në fushat e prokurimit.

		Njoftim për nënshkrimin e kontratës, kontratat e nënshkruara dhe dokumentet të tjera të prokurimit.	prokurim, përkatësisht në KRPP dhe në Zyrën e Informimit.	Komunës së Drenasit, tek linku i Prokurimit.	
12	**Procedurat e punësimit transparente për qytetarët**	Shpallja e konkurseve, njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve, njoftimi për anulimin e konkursit, rishpallja, apo vazhdimi i konkursit, avancimet brenda institucionit.	Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre është Zyra e Informimit.	Publikimi i procedurave në shërbimin civili publikohen ne web faqe zyrtare të Komunës, rrjetet sociale dhe në tabelën para objektit të Komunës.	Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil bëhet në përputhje me legjislacioni e shërbimit civili. Afatet për shpalljen e konkursit, njoftimit të kandidateve, vazhdimi i konkurseve etj.
13	**Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë**	Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si; fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj. Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit.	Komuna harton propozime për Kuvend, ndërsa kjo e fundit miraton aktet që kanë të bëjnë në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, kurse Zyra e Informimit publikon aktet dhe dokumentet që nxirren nga Komuna dhe Kuvendi.	Publikimi i projekt-akteve bëhet në web faqen zyrtare të Komunës.	Publikimi i akteve të miratuara nga Komuna dhe Kuvendi publikohen pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja (vetëm ato që duhet të shqyrtohen për ligjshmëri nga MAPL-ja).

		Përmirësimi sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë.			
14	**Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës**	Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetit vjetor komunal.	Komuna (ekzekutivi) propozon Kuvendit pika të caktuara që janë në interes të përgjithshëm.	Propozimet mund të dalin nga mbledhja e Bordit të ekzekutivit, dhe ju dërgohen Sekretarisë së Kuvendit, pastaj drejtohen të KPF-ja.	Pas caktimit të sugjerimeve, ato dërgohen në Komitetin për Politikë e Financa të cilat caktohen 7 ditë para mbledhjes.
15	**Forcimi i kapaciteteve administrative**	Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës. Rritja e kapaciteteve për shërbimin e Teknologjisë Informative dhe sigurimin e buxhetit nga donacione për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënë	Administrata komunale dhe Kuvendi i Komunës mund të planifikojnë politika për realizimin e kësaj objektive.	Dokumentet që miratohen nga ekzekutivi dhe legjislativi publikohen në web faqe të Komunës.	Njoftimi behët me kohë sipas dispozitave ligjore në fuqi

		s për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit.			
16	**Numëracioni për t'i dhënë informta qytetarëve lidhur me shërbimet që i ofron Komuna si dhe për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe e-maili zyrtar i Komunës**	Numëracioni (080043-853) ka për qëllim bashkëpunimin mes qytetarëve të cilëve u jepet e drejta për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe për t'u informuar me shërbimet e Komunës, si dhe e-maili zyrtar (info.istog@rks-gov.net) ku qytetarët mund të shkruajnë dhe të adresojnë pyetje për punëtorët e administratës komunale.	Drejtoria e Administratës Komunale dhe Zyra e IT-së	Numëracioni është i vendosur në objektin e Komunës dhe në web faqen zyrtare. E-maili zyrtar është i publikuar në web faqe të Komunës	Secila kërkesë, apo ankesë e thirrjeve dhe e dërgimit përmes e-mail, do të këtë afatin ligjor në dispozicion për shqyrtimin e saj.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opstina Istok
Municipality of Istog

00 Numër: ...../2022
data: .....

Rregullorja Komunale Nr...../2022

KUVENDI I KOMUNËS ISTOG

PROJEKT-

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT

Istog, Nëntor 2022

Në bazë të neni 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 17 paragrafi 1 pika s), nenit 34, paragrafi
34.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008e dt.04. qershor 2008"), nenit 4 të Udhëzimit Administrative (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimit dhe Lagjet Urbane, nenit 9, paragrafi 1, pika c), nenit 14, paragrafi 1 shkronja s) dhe nenin 17, të Statuti të Komunës së Istogut 01 Nr. 09-8103, të datës: 29. Shtator 2008, Kuvendi i Komunës së Istogut, në mbledhjen e mbajtur me __.__. 2022, miraton:

RREGULLORE NR. __/2022 PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatar, vendbanime dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të parashikuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore, rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të Komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrjes.

Neni 3
Formimi i këshillave lokale

1. Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësit e parapara më Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Komuna e Istogut do të mbështesë zgjidhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetaret e këshillave lokale. Një këshill lokale mund tëpërfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

2. Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të këshillave lokale dhe janë parashikuar ne nenin 4 paragrafi 4.9 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Formimi i **komisionit nga Kuvendi** i **Komunës për përzgjedhjen këshillave lokale**

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjidhjen e këshillave lokale.
Komisioni duhet te këtë shtatë (7) anëtar, me ketë përbërje: katër (4) anëtar nga Kuvendi i Komunës, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Nga shtatë (7) anëtaret e komisionit tre (3) duhet te jenë femra si dhe një (1) anëtar patjetër të jetë e komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më te madh të anëtarve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtaret e Komisionit. Komisioni i raporton Kuvendit për procesin zgjedhor. Mandati i komisionit është lidhur me mandatin e Kuvendit te Komunës.

2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtje se tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

3. Se paku katër (4) anëtar të komisionit të Kuvendit të Komunës, duhet te jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhor që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetrarëve të këshillave lokale.

5. Të gjithë qytetarët pjesëmarrës në tubimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Komisioni i emëruara nga Kuvendi i Komunës, është i obliguar që ti shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës, tu kthej përgjigje më shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.

6. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

6.1 shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuarabrenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
6.2 Mediave lokale;
6.3 Ueb-faqes zyrtare të Komunës dhe
6.4 Rrjetet sociale.

7. Njoftimi Publik duhet të përmbajë:

7.1 Rendin e Ditës;
7.2 Data e mbajtjes së tubimit,
7.3 Koha e mbajtjes së tubimit,
7.4 Vendi i Mbajtjes së tubimit,

8. Në territorin e **Komunës së Istogut, formohen këto këshilla lokale si me poshtë:**

(duke ju referuar statistikave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 4 paragrafi r pika 2.4)

8.1 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Istogu 1, Rruga " Fadil Fertati" (pjesa jugore) Rruga "Ibrahim Rugova", Rruga Rexhë Murati" dhe Rruga Rinia (pjesa jugore).

8.2 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Istogu 2, Rruga " Fadil Fertati" (pjesa veriore), Rruga "UÇK", Rruga "Lidhja e Prizrenit", Rruga "Hysena Bujupaj" dhe fshati Synej.

8.3 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Gurrakoci

8.4 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Rakosh – Kërrninë – Zhakovë.

8.5 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Banjë – Lubovë – Dubov e Vogel.

8.6 Këshilli lokal i lagjeve urbane: Vrellë,

8.7 Këshilli lokal i fshatrave: Saradran – Dobrush,

8.8 Këshilli lokal i fshatrave: Istog i Poshtem – Drogolec,

8.9 Këshilli lokal i fshatrave: Shushic – Mojstir – Bollopoj,

8.10 Këshilli lokal i fshatrave: Istog Lagja e Llullakve - Cerrcë – Lubozhdë,

8.11 Këshilli lokale i fshatrave: Trubohoc – Prekall – Zabllaq,

8.12 Këshilli lokal i fshatrave: Orroberd – Kaliqan,

8.13 Këshilli lokal i fshatrave: Studenic (Stupe – Kamenic),

8.14 Këshilli lokal i fshatrave: Uçë – Cerkolez – Sohogerllë,

8.15 Këshilli lokal i fshatrave: Veriq – Veriq i ri – Tuqep – Dubrava dhe Serbobran,

8.16 Këshilli lokal i fshatrave: Lluga – Llukafc – Prigod,

8.17 Këshilli lokal i fshatrave: Tomoc – Muzhevina – Kovragë ,

8.18 Këshilli lokal i fshatrave: Osojan – Llukafc i That – Belic – Shalnavic,

8.19 Këshilli lokal i fshatrave: Kashic – Baic – Corolluk,

8.20 Këshilli lokal i fshatrave: Zallq – Drejë – Kosh – Polonë

Neni 5
Formimi i **këshillave lokale dhe kriteret** e **përzgjedhjes**

1. Këshilli i lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të këtë nga 5 (pesë) deri 9 (nëntë) anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshillë lokal, përcaktohet nga vetë banoret e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në taste kur këshilli lokal ka numër qift të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, fshati, vendbanimi apo lagja urbane me numër me te madha të banorëve jep dy anëtar në këshillin lokal.

3. Përbërja e këshillave lokale duhet te reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore, sipas Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane neni 6 pika 2 UA). Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane jetojnë pjesëtar të komuniteteve joshumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse janë të pranishëm në tubim. Nëse kemi më shumë se një komunitet të pakicës, komuniteti që ka shumicën duhet të përfaqësohet në këshillin lokal.

4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal më rastin e tubimit të qytetarëve, që mblidhen të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimitdhe lagjes urbane.

5. Zgjedhja behët përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.

6. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.

7. Kandidatët për pozita të anëtareve dhe të kryetarëve të këshillave lokale nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur në poste politike.

8. Anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.

9. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili ka me shumë shumicën vota nga qytetarët që marrin pjesë në atë tubim.

10. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo me shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë organizohen rrethi i dyte i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjidhet për anëtar, kryetar i këshillit lokal.

11. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Numri i kandidatëve të propozuar për këshill lokal duhet të jetë me lartë se numri i përcaktuar për tu zgjedhur.

12. Anëtaret dhe kryetaret e këshillave lokale të fshatit, vendbanimeve dhe logjeve urbane, zgjidhen me mandate 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandate.

13. Tubimet kanë legjitimitet juridik, nëse në tubime janë të pranishëm se paku 20 pjesëmarrës më të drejtë vote të atij lokaliteti.

Neni 6
Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetareve të këshillave lokale

1. Në raste kur qytetarët konsiderojnë se anëtaret ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtaret dhe kryetari i këshillit mund të shkarkohet me shumicën e votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane më rastine tubimit publik me qytetarë.

2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet te mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysmë numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Peticioni protokollohet dhe i dorëzohet Drejtorisë së Administratës dhe sektorit për punët e Kuvendit, të cilët pastaj e procedojnë tek anëtaret e Komisionit të formuar sipas nenit 4 pika 1, të cilët anëtarë duhet të lajmërohen paraprakisht për një mbledhje të tillë.

3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave të parapara në paragrafin 2, një votim i ri duhet të behët menjëherë, në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në mënyre që të zgjidhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloje.

4. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokalë përfundon:
   4.1 Me kryerjen e mandatit;
   4.2 Nëse vdes;
   4.3 Nëse jep dorëheqje;
   4.4 Nëse ndërron vendbanim;
   4.5 Nëse shkarkohet dhe
   4.6 Në rast së dënohet për vepër penale me një urdhër me burgime për gjashtë (6) muaj ose me tepër.

Neni 7
Procesverbali nga tubimi zgjedhor

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së tubimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.

2. Procesverbalin e nënshkruajnë Kryesuesi i tubimit, anëtaret e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimit dhe për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane.

3. Rezultate e zgjedhjeve, emrat e anëtarve dhe te kryetarit te këshillit lokal, duhet te behën publik menjëherë pas tubimit zgjedhor.

Neni 8

Konsultimet ndërmjet Komunës dhe këshillave lokale

1. Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtori për Administratë, ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet rregullat publike, takimet për planifikim të politikave zhvillimore komunale që organizohen nga organet komunale.

2. Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale qe janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.

3. Kryetari i Komunës duhet te organizoj se paku dy takime ne vit me udhëheqësit e këshillavelokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj e parë të vitit fiskal dhe një në gjashtëmujorin e dytë të vitit fiskal (por takimet mund të jene edhe sipas nevojave të Këshillave Lokale). Për rendin e ditës duhet të konsultohet edhe udhëheqësit e këshillave lokale.

4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 9
Bartja e aktiviteteve nga Komuna te këshillat lokale

1. Me kërkesë të këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit te Komunës apo ndonjë komiteti të Kuvendit.
Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për ti ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të Komunës.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranoj bartjen aktiviteteve nga Kuvendi Komunës në këshillin lokal.

3. Në rast të bartjes se aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, Komuna do të angazhohet të ofrojë mbështetje dhe burime të mjaftueshme për zyrat lokale/këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartura.

Neni 10
Roli, detyrat dhe përgjegjësit e **këshillave lokale**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohen në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.

2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urban, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat ne bashkëpunim më Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, komitetet dhe drejtoritë komunale.

3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet te informojë komunën për kohen dhe agjendën e takimeve. Zyrtare kompetent komunale mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.

4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

5. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet, të cilat në veçanti ndikojnë në:

5.1 Planifikimin urban dhe rural;
5.2 Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;
5.3 Shëndetësinë publike;
5.4 Mbrojtjen lokale të ambientit;
5.5 Turizmin;
5.6 Hapësirave publike dhe varrezave;
5.7 Aktiviteteve kulturore dhe sportive etj.

6. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë më shkrime organeve kompetente të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit kurse organet e Komunës brenda afatit 45 ditë i përgjigjen me shkrime këshillit lokal qe ka parashtruar kërkesën.

Neni 11
Roli i kryetarëve të këshillave të fshatrave

1. Kryetari i këshillit të fshatrave përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës. Kryetari i Këshillit lokal ka obligim ti informoj anëtaret e Këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet e përshkruara në paragrafin paraprak.

2. Kryetari i këshillit të fshatrave thërret dhe udhëheq me mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdesetpër organizimin dhe punën e këshillit. Po ashtu, ai i nënshkruan rekomandimet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar qe në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre ti dorëzoj te Kryetari i Komunës.

Neni 12
Financimi i aktiviteteve

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon:

1.1 Banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane,
1.2 Komuna përkatëse;
1.3 Donatorët; dhe
1.4 Financim të përbashkët.

Neni 13
Kompensimi i këshillave lokale

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Do të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane neni 12.

Neni 14
Mos përmbushja e përgjegjësive

Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhepërgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga Kuvendi i Komunës në këshillin lokal.

Neni 16
Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit apo Statutit.

2. Me hyrje ne fuqi te kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane e Komunës së Istogut Nr.3/2012 e datës 30.07.2012.

3. Për zbatimin e kësaj Rregullore do te kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtori për Administratë.

Neni 18
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
MUNICIPALITY OF ISTOK

01 Numër: /2022 **:http://kk.rks-gov.net/istog/**
Data: .2022

Rregullore Komunale Nr. /2022

KUVENDI I KOMUNËS

Projekt- RREGULLORE

PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

NËNTOR/2022

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 12.2 pika c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2, pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave të Ligjit Nr. 2003/24, për Sport, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-075 për Sport, Rregullores së (MKRS-së) Nr.04/2018 për kategorizimin e sporteve, si dhe në bazë të nenit 33 paragrafit 33.1 nëparagrafi 1 të Statutit të Komunes së Istogut 01.Nr62/2022 të dates 30.11.2020, Kuvend i i Komunes, ne mblcdhjen e mbajtur me ……. miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat, kriteret, procedurat dhe poentimin për kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut që marrin pjesë në garat sportive të organizuara nga Federatat Sportive të regjistruara në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Republikës së Kosovës dhe në Komunën e Istogut.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje rregullojn:
   1.1. mënyra e kategorizmit të klubeve sportive;
   1.2. kriteret për kategorizimin e klubeve sportive;
   1.3. procedurat për kategorizimin e të gjitha klubeve sportive;
   1.4. procedurat e ankimimit;
   1.5. dispozitat përfundimtare.

Neni 3
Mënyra e kategorizimit të klubeve sportive

1. Kategorizimin e klubeve sportive e bënë Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, duke marrë parasysh kriteret për kategorizimin e klubeve sportive të cilat janë përcaktuar në dispozitat e Kësaj Rregulloreje.

2. Në bazë të kësaj rregulloreje, Kategorizimi i Klubeve Sportive të Komunës së Istogut bëhet një herë në vit.

Neni 4
Kriteret për kategorizimin e klubeve sportive

1. Kriteret për kategorizimin e klubeve të Sportit janë si në vijim:
   1.1. niveli (rangu) i sportit, sipas Kategorizimit Nacional të Sporteve - **KRITERI I**,
   1.2. tradita e klubit sportiv (viti i themelimit të klubit) – **KRITERI II**,
   1.3. numri i sportistëve të regjistruar – **KRITERI III**,
   1.4. niveli i garave ku merrë pjesë klubi – **KRITERI IV**,.
   1.5. rezultatet e arritura sportive - **KRITERI V**,
   1.6. angazhimi në përfaqësuese të Kosovës – **KRITERI VI**,
   1.7. pjesëmarrja e klubeve në aktivitete dhe gara – **KRITERI VII**,
   1.8. organizimi i kompeticioneve, garave, aktiviteteve – **KRITERI VIII**,
   1.9. ngritja e kapaciteteve – **KRITERI IX**,
   1.10. dokumentacioni – **KRITERI X**.
2. Përmbushja e kritereve nga Neni 3 i kësaj rregulloreje përfshinë të gjitha kategoritë (të gjitha grup – moshat për meshkuj dhe femra) e sportistëve, por numri i pikëve për kategoritë e reja zvogëlohet:
   2.1 për junioret- 50% të pikëve për seniorë,
   2.2 për kadetë dhe pionerë -75% të pikëve për seniorë.
3. Rezulltati sportiv që arrinë një klub i sportit individual njihet si rezultet i sportit ekipor, me kusht që ky rezultat të jetë i pranuar nga federata përkatëse e sportit.

Neni 5
Procedura për kategorizimin e klubeve sportive

1.Komisionin për Kategorizimin e klubeve sportive e themelon me vendim Kryetari i Komunës duke rrespektuar Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore me këtë përbërje:
   1.1. komisioni përbëhet nga 5 anëtar,
   1.2. një anëtar i dëshmuar në fushën e sportit.
   1.3. një anëtar nga DKRS-ja.
   1.4. tre anëtar nga institutcioni
   1.5 një anëtar rezervë

2. Komisioni gjatë punës mbanë procesverbalin, i cili në fund nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.

3.Komisioni vlerëson me pikë klubet sipas kritereve të përckatuara në këtë rregullore dhe vendimin për kategorizimin e klubeve sportive duhet t'a marrë më së largu deri me 15 Shkurt.

Neni 6
Dërgimi i formularit për aplikim

1.DKRS-ja, më së largu deri me datën 15 Janar, u'a dërgon të gjitha klubeve të Komunës së Istogut formularin përkatës për aplikim për kategorizim të sporteve. Në formular përcaktohen dëshmitë përkatëse që duhet të sjellë klubi.
2.Vlera financiare e pikëve të kategorizimit të Klubeve Sportive caktohet me njoftim nga DKRS .
3.Klubet Sportive janë të obliguara të plotësojnë formularin dhe t'ia bashkëngjisin dokumentacionin mbështetës sipas kërkesës në formular së bashku me dëshmitë përkatëse, të cilat i dërgojnë në DKRS-se, më së voni deri me datën 31 Janar.
4.Nëse klubet përkatëse dorëzojnë formularin dhe dokumentacionin përkatëse me vonesë dhe konstatohet se dëshmitë e bashkëngjitura nuk kanë qenë ashtu si janë kërkuar në formular, i njejti aplikim nuk pranohet dhe klubi nuk do të kategorizohet.

Neni 7
Shqyrtimi i dokumentacionit dhe lista ranguese

1.Komisioni, shqyrton aplikacionet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore,

2.Komisioni bënë vlerësimin e dokumentacionit përkatës, i përgatit propozimet për rangim, të cilat pastaj i miraton.

3. Komisioni është i obliguar që listën me Kategorizim të Sporteve të miratoj më së largu deri me datën 15 Shkurt.

Neni 8
E drejta e ankesës, afatet dhe procedura

1. Klubet e pakënaqura me radhitjen në grupe, mund të parashtrojnë ankesën e tyre në Komisionin për Ankesa brenda afatit 15-të ditor, pas marrjes së listës.

2. Komisioni i Ankesave për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, pas shqyrtimit të Ankesës vendos me shumicë votash dhe nxjerr vendim përfundimtar brenda 15 ditësh lidhur me ankesën e parashtruar.

3. Komisionin e Ankesa lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut e themelon Kryetari i Komunës.

4. Komisioni i Ankesave ka Kryetarin (që duhet të jetë juristë) dhe anëtarët e tjerë, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë anëtarë të emëruar politik.

5.Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave nuk mund të parashtrohet ankesë brenda instutucionit

Neni 9
Vendimi për kategorizmin e sporteve

Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive është i obliguar të pres vendimin e fundit të Komisionit të Ankesave lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe të vendosë në pajtim me vendimin përfundimtar të Komisionit të Ankesave për kategorizimin e klubeve sportive dhe të publikohet lista.

Neni 10
Mbështetja financiare e klubeve sportive sipas kategorizimit

1. Komisioni dhe ndarja e mjeteve financiare do të bëhet në bazë të Rregullores MF - Nr – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare për klubet sportive bëhet duke pasur për bazë kategorizimin e klubit sportiv për vitin e fundit si dhe buxhetin e aprovuar për vitin përkatës.

3.Pas vendimit të Komisionit për Kategorizimin e Klubeve Sportive, DKRS rekomandon marrëveshje me shkrim për mbështetje financiare me klubet sportive përkatëse duke u mbështetur në planin e aktiviteteve dhe atë financiar të paraqitura nga klubet sportive.

Neni 11
Shtojca e Rregullores

1. Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, është i obliguar që të hartojë formularin me pyetje përkatëse, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Tabela poentuese dhe formulari me pyetjet përkatëse janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 12
Ndryshimet dhe plotësimet

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në të njejtën mënyrë sikurse dhe miratimi i saj.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së, si publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës

Kryesuesi Kuvendit
z.Enver Rugova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

TABELA POENTUESE PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Nr.	KRITERET	Pikët
1.	Rangu i Sportit në nivel Nacional	
1.1	Rangu I	2.0
1.2	Rangu II	1.5
1.3	Rangu III	1.0
1.4	Rangu IV	0.5
2.	**Tradia e Klubit**	
2.1	Klubi me traditë i formuar nga 1997 dhe më përpara	4.0
2.2	Klubi me traditë i formuar nga 1997-2000	3.0
2.3	Klubi me traditë i formuar nga 2000-2003	2.0
2.4	Klubi me traditë i formuar nga 2003 e tutje	1.0
3.	**Numri Sportistëve të regjistruar**	
3.1	Së paku 60 sportistë e më shumë	4.0
3.2	Nga 40-59 sportistë	3.0
3.3	Nga 20-39 sportistë	2.0
3.4	Nga 5-19 sportistë	1.0

4	**Niveli i garave**	
4.1	Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka 3 e më shumë liga	6.0
4.2	Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka me 2 liga	4.0
4.3	Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka me 1 liga	2.0
5.A	**Rezultatet e arritura sportive në sportet ekipore**	
5.1	Klubi – Niveli I – Vendi I	10.0
5.2	Klubi – Niveli I – Vendi II	8.0
5.3	Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë	/
5.4	Klubi – Niveli II – Vendi I	6.0
5.5	Klubi – Niveli II – Vendi II	4.0
5.6	Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë	/
5.7	Klubi – Niveli III – Vendi I	3.0
5.8	Klubi – Niveli III – Vendi II	2.0
5.9	Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë	/
5.B	**Rezultatet e arritura sportive në garat për Kupën e Kosovës**	
5.1	Klubi – Fitues i Kupës së Kosovës	10.0
5.2	Klubi – Finalist i Kupës së Kosovës	8.0
5.3	Klubi – Gjysëm finalist i Kupës së Kosovë (1/2 e finales së kupës)	6.0
5.4	Klubi – Çerek finalist i Kupës së Kosovës (1/4 e finales së kupës)	4.0
5.C	**Rezultatet e arritura sportive në sportet individuale**	
5.1	Për çdo medalje ndërkombëtare në Lojërat Olimpike klubi merr - Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak	26.0
5.2	Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionatet Botërore klubi merr - Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak	23.0
5.3	Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionate dhe Lojërat Evropiane - Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak	20.0
5.4	Për çdo medalje ndërkombëtare në Lojërat Mesdhetare - Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak	16.0
5.5	Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionatet Ballkanike - Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak	14.0
5.6	Për çdo medalje në Kampionatin e Kosovës dhe në garat për Kupën e Kosovës - Vendi 1/3, Vendi 2/2 dhe Vendi 3, nga 1 pikë	3.0
5.7	Për çdo rekord të ri sportiv të vendosur	3.0
6.	**Angazhimi në përfaqësuese**	
6.1	Për çdo sportist të angazhuar në përfaqësuese	1.0
6.2	Për çdo trajner të angazhuar në përfaqësuese	1.0
7.	**Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara**	
7.1	Klubi që merrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete	4.0

7.2	Klubi që merrë pjesë në 20-29 aktivitete	3.0
7.3	Klubi që merrë pjesë në 10-19 aktivitete	2.0
7.4	Klubi që merrë pjesë në 4-9 aktivitete	1.0
8.	**Organizimimet**	
8.1	Organizimi i Kampionateve dhe garave për kupë në nivel Nacional	3.0
8.2	Organizimi i turneve ndëkombëtare (së paku 4 ekipe pjesëmarrëse nga 4 shtete të ndryshme).	3.0
8.3	Organizimi i turneve në nivel Nacional (së paku 4 ekipe pjesëmarrëse nga 4 komuna të ndryshme)	2.0
8.4	Organizimi i seminareve, ligjeratave, trajnimeve	2.0
9.	**Ngritja e kapaciteteve**	
9.1	Për çdo trajner me licencë të njohur ndërkombëtare	0.5
9.2	Për çdo trajner me licencë të njohur nacionale	0.3
9.3	Për çdo administrator të sportit me licencë të njohur	0.3
9.4	Për çdo zyrtar tjetër të sportit me licencë të njohur	0.3
10.	**Dokumentacioni**	
10.1	Plani strategjik	2.0
10.2	Plani i veprimit	2.0
10.3	Raporti i punës duke përfshirë në të edhe raportin financiar	2.0
10.4	Raporti financiar nga një auditor i pavarur	3.0
10.5	Procesverbali i mbajtjes së Kuvendi të Klubit	3.0

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

Istog, me: ___/ ___/_____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ *ja* i/*e* klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

FORMULARI PER APLIKIM PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Kriteri1. Sipas rangut të sportit në nivel nacional.

NË CILEN KATEGORI, RANG BËNË PJESË SPORTI ME TË CILËN MERRET KLUBI JUAJ, SIPAS KATEGORIZIMIT NACIONAL? Duhet të sillni deshmi për të vërtetuar të dhënat	
➢ Në rangun I	☐
➢ Në rangun II	☐
➢ Në rangun III	☐
➢ Në rangun IV	☐

Kriteri 2: Tradita e klubit

CILA ËSHTË TRADITA E KLUBIT TUAJ, APO KUR ËSHTË FORMUAR KLUBI JUAJ? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat.	
➢ Klubi me traditë i formuar nga viti 1997 dhe më përpara	☐
➢ Klubi me traditë i formuar nga viti 1997-2000	☐
➢ Klubi me traditë i formuar nga viti 2000-2003	☐
➢ Klubi me traditë i formuar nga viti -2003 dhe më mbrapa	☐

Kriteri 3: Masiviteti sipas numrit të sportistëve dhe ekipeve të regjistruar në federatë

Kriteri 3.1. Masiviteti sipas numrit të sportistëve dhe ekipeve të regjistruar në federatë

SA ËSHTË NUMRI I SPORTISTEVE TË KLUBIT TUAJ TË REGJISTRUAR NË FEDERATËN TUAJ PËRKATËSE? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat, të bashkangjitet lista e sportisteve të	
➢ Klubi ka të regjistruar 60 sportiste e më shumë	☐
➢ Klubi ka të regjistruar 40-59 sportiste	☐
➢ Klubi ka të regjistruar 20-9 sportiste	☐
➢ Klubi ka të regjistruar 5-19 sportiste	☐

Kriteri .3.2: Masiviteti në bazë të ekipeve sportive qe garojnë

SA EKIPE SPORTIVE NUMËRON KLUBI JUAJ DHE TË CILAT JANË AKTIVE DHE GAROJNË? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja	
➢ Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (meshkujt)	☐
➢ Klubi ka ekipin e juniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive	☐
➢ Klubi ka ekipin e kadetëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive	☐
➢ Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (femra)	☐
➢ Klubi ka ekupin e juniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive	☐
➢ Klubi ka ekipin e kadetëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive	☐

Kriteri 4: Niveli i garave, rangu ku klubi zhvillon gara

NË CILIN NIVEL, RANG APO KATEGORI ZHVILLON GARA KLUBI I JUAJ? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja	
➢ Klubi juaj bënë gara në rangun e pare të garave në federatën tuaj	☐
➢ Klubi juaj bënë gara në rangun e dytë të garave në federatën tuaj	☐
➢ Klubi juaj bënë gara në rangun e tretë të garave në federatën tuaj	☐

Kriteri 5: Rezultatet sportive
Kriteri 5.1. Rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALE NË LOJËRAT OLIMPIKE (LO), NË LOJËRAT PARA – OLIMPIKE, NË KAMPIONATIN BOTËROR (KB) LOJËRAT DHE KAMPIONATET EVROPIANE, LOJËRAT MESDHETARE APO KAMPIONATET BALLKANIKE, APO QË ËSHTË RADHITUR NGA VENDI 4-TË DERI NË VENDIN E 8-TË. Duhet të sillni dëshmi për të vëtetuar të dhëna tuaj	
➢ Shëno kampionatin,	

Garën në të cilën është arritur rezultati (vendi, data)	
➢ Emri dhe Mbiemri i Sportistit	
➢ Rezultati i arritur	
➢ Kategoria/ disiplina	

Kriteri 5.2: Rezultatet e arritura në garat vendore

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE TË ARTË, TË ARGJENDTË APO TË BRONZTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS, APO NDONJË SPORTIST I KLUBIT TUAJ QË KA ZËNË VENDIN E PARË APO TË DYTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS APO NË NË KUPËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja	
➢ Shëno Kampionatin, garën ku është arritur rezultati (vendi, data)	
➢ Emri dhe Mbiemri i sportistit	
➢ Rezultati i arritur	
➢ Kategoria/ disiplina	

Kriteri 6: Përfaqësimi, angazhi mi i sportistëve dhe trajnerëve në përfaqësuese

A KENI NDONJË SPORTIST APO TRAJNER NË KLUBIN TUAJ I CILI ËSHTË ANGAZHUAR NË PËRFAQËSUESEN E KOSOVËS?	
➢ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar sportist	☐
➢ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar trajner	☐
➢ Emri dhe Mbiemri i sportistit apo trajnerit	
➢ Kategoria	

Kriteri 7: Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara

A KA MARRË PJESË KLUBI I JUAJ NË AKTIVITETE APO GARA TË NDRYSHME SPORTIVE? SHËNONI NË SA PREJ TYRE DHE CILAT JANË ATO? Duhet të sillni deshmi për të vertetuar të dhënat tuaja.	
➢ Klubi juaj ka marrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete gjatë vitit	☐
➢ Klubi juaj ka marrë pjesë në 20-29 aktivitete gjatë vitit	☐
➢ Klubi juaj ka marrë pjesë në 10-19 aktivitete gjatë vitit	☐
➢ Klubi juaj ka marrë pjesë në 4-9 aktivitete gjatë vitit	☐
➢ Përshkrimi i aktivitetit të organizuar	
➢ Kohëzgjatja, datat	
➢ Vendi	

Kriteri 8. Organizimi i kompeticioneve, garave dhe aktiviteteve

A KENI ORGANIZUAR KAMPIONAT TË KOSOVËS, KUPËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, APO TURNE, GARË, MANIFESTIM SPORTIV ME KARAKTERË VENDOR APO NDËRKOMBËTAR? Duhet të sillni deshmi për të vertetuar të dhënat tuaja.	
➢ Përshkrimi kompeticionit/ aktivitetit të organizuar	
➢ Kohëzgjatja, datat	
➢ Vendi	

Kriteri 9. Ngritja e kapaciteteve

A KENI NDONJË ZYRTAR TË SPORTIT (TRAJNER, DELEGATË, REFER, MJEKË, FIZIOTERAPEUT, ADMINISTRATORË) TË KUALIFIKUAR SIPAS STANDARTEVE NDËRKOMBËTARE APO STANDARTEVE TË PËRCAKTUARA NGA FEDERATA E JUAJ? Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja	
Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (meshkujt)	☐
1. TRAJNERË	☐
2. DELEGATË	☐
3. MJEKË SPORTIV	☐
4. FIZIOTERAPEUT SPORTIV	☐
5. REFERË	☐
6. ADMINISTOR TË SPORTIT	☐

Kriteri 10. Dokumentacioni

DOKUMENTACIONI PËRBËNË KRITERIN E FUNDIT PËR VLERËSIMIN E KATEGORIZIMIT TË KLUBIT PËRKATËS. A KA KLUBI JUAJ RRREGULLORE, PLAN – PROGRAME, RAPORTE TË MIRATUARA NGA KUVENDI APO BORDI I KLUBIT?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja	
1. PLAN PROGRAM PËR NGRITJEN E CILËSISË SPORTIVE	☐
2. PLAN PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN DHE RRITJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE NË SPORT	☐
3. PLAN PROGRAM EDUKATIV NË SPORT PËR FËMIJË	☐
4. RREGULLORE PËR ANTI-DOPING	☐
5. VETËDIJËSIMI NGA HULIGANIZMI DHE DHUNA NË SPORT	☐
6. NDËRGJEGJËSIMI I ANËTARËVE TË KLUBIT NGA ÇFARËDO FUSHE TJETËR	☐
7. RREGULLORE DISIPLINORE	☐
8. RREGULLORE MBI KODIN E ETIKËS	☐
9. RREGULLORE MBI SIGURINË NË GARA/ NDESHJE	☐
10. RREGULLORE MBI TRUKIMIN E NDESHJEVE/ GARAVE	☐
11. PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KUVENDIT TË KLUBIT	☐
12. RAPORTI MBI PUNËN E KLUBIT NGA VITI PARAPRAK	☐
13. RAPORTI FINANCIAR I MIRATUAR NGA KUVENDI I KLUBIT	☐
14. RAPORTI FINANCIAR NGA AUDITI I PAVARUR	☐
15. RREGULLORE MBI ÇFARËDO FUSHE TJETËR	☐

VËREJTJE

Formularit mund t'i bashkangjitet edhe arsyetimi shtesë nëse është e nevojshme për të arsyetuar veprimtarinë, angazhimin rezultatet apo vlerat e klubit.

Emri, Mbiemri i Sekretarit të Klubit	
Tel:	
E-mail:	

Emri, Mbiemri i Kryetarit të Klubit	
Tel:	
E-mail:	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY OF ISTOK
OPŠTINA ISTOK

PYETËSOR PËR
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE
NE KOMUNËN E ISTUGUT

Istog, me: ___/ ___/_____.

Klubi: _____

Përfaqësuesi/ *ja* i/*e* klubit: _____

Tel: _____

E-mail: _____

Nr.	**KRITERI**	**TË DHËNAT**	
1.	Rangu i sportit		
2.	Tradita e klubit		
3.	Numri i sportistëve të regjistruar		
4.	Niveli i Garave		
5.	Rezultatet e arritura sportive		
6.	Angazhimi në përfaqësuese të Kosovës		
7.	Pjesëmarrja e klubeve në aktivitete dhe gara		
8.	Organizimi i kompeticioneve, garave, aktiviteteve		
9.	Ngritja e kapaciteteve		
10.	Dokumentacioni		

VËREJTJE

Këtij pyetësori duhe t’i bashkangjiten dokumentet me të cilat vërtetohen të dhënat e shënuara në pyetësor.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
RepublicofKosovo

Komuna e Istogut
OpshtinaIstok
Municipalityof Istog

00 Numër: __/___
Data: __.__.2022

:http://kk.rks-gov.net/istog/

Rregullore Komunale Nr. __/2022

KUVENDI I KOMUNËS

Projekt -

RREGULLORJA
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

_____/2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2pika c), dhe nenit 40 paragrafit 40.2 të Ligjit për Vetëqeverise Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës sëKosovësNr.28/2008), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008) dhe neneve:
33 paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 34 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Istogut01nr.62/2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë: . .2022 miratoi këtë:

RREGULLORE
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen të gjitha të hyrat komunale duke përfshirë taksat për kryerjen e shërbimeve, lejet, ngarkesat dhe gjobat e ndryshme të cilat do të arkëtohen nga Drejtoritë Komunale.

Neni 2
Drejtoria për Administratë

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Regjistrimi në Gjendjen Civile	
1.1. Kompletimi i dosjes për aplikim te lirimi dhe fitim te shtetësisë.	20
1.2. Lidhja e martesës jashtë institucionit dhe jashtë orarit të punës;	50
1.3. Lidhja e martesës jashtë orarit të punës brenda institucionit;	15
1.4. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në "Regjistri i Martesës" me procesverbal;	5
1.5. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në "Regjistri i Martesës" me shtetasin e huaj me procesverbal;	30
1.6. Marrja e Aktvendimit mbi ndryshimin e emrit personal në "Regjistri i Lindjes" dhe "Regjistri i Martesës"	30
1.7. Përmirësimi i germëzimit të emrit personal;	3
1.8. Anulimi i regjistrimit të lindjeve në dy komuna;	10
2. Lëshimi i dokumenteve te gjendjes civile	
2.1. Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	1
2.1.1 Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile jashtë vendit; e re	2
2.2. Certifikata e lindjes brenda vendit;	1
2.2.1. Certifikata e lindjes jashtë vendit; e re	2
2.3. Certifikata e martesës brenda vendit;	1
2.3.1. Certifikata e martesës jashtë vendit; e re	2
2.4. Certifikata e vdekjes brenda vendit;	1
2.4.1.Certifikata e vdekjes jashtë vendit; e re;	2
2.5. Certifikatë e Statusit Martesorë brenda vendit.	1
2.5.1.Certifikatë e Statusit Martesorë jashtë vendit; e re.	2

2.6. Certifikata e vendbanimit brenda vendit;	1
2.6.1. Certifikata e vendbanimit jashtë vendit; e re	2
2.8. Certifikata e shtetësisë brenda vendit ;	1
2.8.1. Certifikata e shtetësisë jashtë vendit; e re. ;	2
3. Vërtetimet e gjendjes civile	
3.1. Vërtetimi mbi konfirmimin e emrit personal;	5
3.2. Vërtetimi mbi mjetet për jetesë;	5
3.3. Vërtetimi i nënshkrimit përshkrimit dhe dorëshkrimit;	2
3.4. Vërtetime të ndryshme;	5
3.5. Njohja e vendimit nga shteti i huaj për ndryshim te emrit.	10
3.6. Vërtetimi nga arkiva	1
3.7. Vërtetimi për ndërrimin e vendbanimit	1
3.8. Formular për shtesa të fëmijëve në botën e jashtme;	1
4. Vërtetimi i deklaratave	
4.1. Deklarata për bashkësinë familjare;(sipas UA Nr.24/2015)	2
4.1.1. Deklarata e bashkësisë familjare jashtë vendit; e re.	2
4.2. Deklaratë e gjendjes personale të personit fizik;	2
4.3. Dëshmi mbi vdekjen dhe përshkrimin e pasurisë; (Aktvdekja)	2
5. Përpilimi dhe parashtrimi i shkresave-kërkesave	
5.1. Parashtrimi i kërkesave të ndryshme drejtuar organeve komunale	1
5.2 Referencat për operatoret ekonomik	5

Neni 3
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Dhënia e aktit për kushte tekniko-urbanistike për zonat që nuk kanë plan rregullues urban	Shuma në €
1.1. Për parcelimin e parcelës;	30
1.2. Muret rrethuese;	10
1.3. Për objekte të përkohshme-afariste;	20
1.4. Për objekte ndihmëse;	2
1.5. Për garazhe;	15
1.6. Kërkesa për shfrytëzimin të dokumentacionit të shërbimeve Pronësoro-Juridike per banesa;	5
1.7. Për vazhdimin e Lejes për ndërtim dhe lëshimi i LN duplikat;	30
1.8. Vërtetime dhe pëlqime te ndryshme	10
2. Taksat për leje ndërtimi	
2.1. Për ndërtimin e objektit të të gjitha llojeve;	2.56 € m²
2.2. Tarifa rregullative për densitetin të infrastrukturës për objekte për banim (m²/50)*99.87 p.sh. (100/50)*99.87=199.74€;	Tarifa e llog.99.87

3. Lëshimi i lejes komunale mjedisore sipas UA Nr.01/2017	
3.1.Tarifat ne vlerën investive te projektit deri 25,000 euro	50
3.2. Tarifat ne vlerën investive te projektit mbi 25,000 euro	0.2% të vlerës investive
3.3. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt individual shtëpi banimi;	30
3.4. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt shumëbanesore për çdo banesë;	20
3.5. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste brenda objektit shumëbanesor;	20
3.6. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste individuale;	30
3.7. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale objekte industriale.	100
3.8. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për hotele, motele dhe restorante.	80
4. Leje tjera	
4.1. Leje përvendosja e foltoreve telefonike;	10
3.2. Leje për shtrirjen e rrjetit kabllor(ajror) të internetit, për metër gjatësi;	0.05
3.3. Leje për shtrirjen e rrjetit elektrik(ajror) për metër gjatësi;	0.03
3.4. Leje për vendosje e ormanëve shpërndarëse MDF, për copë;	15
3.5. Leje për ndërtimin-vendosjen e trafove elektrike;	20
3.6. Leje për vendosjen e antenave;	20
3.7. Leje për përçoja nëntokësore: kanalizim, ujësjellës, rrjet kabllor elektrikë, rrjetë kabllor të internetit etj, për metër gjatësi.	0.06
3.8. Leje për rrënim për m^2 e re	1
4. Kompensimi për tokën ndërtimore ne zonat urbane të cilën Komuna e ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm paguhen (për një muaj)	
4.1. Sipërfaqja prej 1-10 m^2,	**5**
4.2. Sipërfaqja prej 11-30 m^2,	**4**
4.3. Sipërfaqja prej 31-50 m^2,	**3**
4.4. Sipërfaqja mbi 51 m^2, në lartësi prej.	2.5
5. Taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike përkohësisht.(prej 0-1 vit)	
5.1. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një ditor;	10
5.2. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një javor;	15
5.3. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një muaj;	20
5.4. Leje për vendosjen e tavolinave para lokaleve hotelieреve për m^2 –mujore	2
6. Vendosja e pllakateve reklamuese në hapësira publike tarifa (mujore) për m^2	
6.1. Pllakatet;	5
6.2. Pllakatet reklamuese me ndriçim;	6
6.3. Vendosja e reklamave elektronike reklamuese;	9
6.4. Vendosja e reklamave në muret e ndërtesave publike	6
6.5. Vendosja e banereve-mujore	20
7. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme.	

7.1. Vendosja e aparateve për lojëra argëtuese , ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit;	20
7.2. Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese). Tarifa mujore për c	0.50
8. Shërbime tjera	
8.1. Shfrytëzimi i hapësirave te ndërtesave ne pronësi te komunës per m^2 ne muaj	1.5
9.Taksa për trajtimin te ndërtimeve pa leje (Ligji 06/L-024)	
9.1 Taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe ndërtimeve pa lej të Kategorisë II që janë shtëpi është një euro për metër katror m2	1
9.2. Taksa për legalizimin e llojeve vijuese të ndërtimeve pa leje është dy euro për metër katror për m2	2
9.2.1ndërtimet e kategorisë II të cilat nuk janë shtëpi për m2	2
9.2.2. Ndërhyrjet në ndërtimet me leje për m2	2
10. Taksë për ndërtimin e tokës bujqësore sipas PZHK-së	
10.1. Kategoria e parë (Kalsa I deri IV) për m^2	1
10.2. Kategoria e dytë (Kalsa V deri VI) për m^2	0.75
10.3. Kategoria e tretë (Kalsa VII deri VIII) për m^2	0.50

Neni 4
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale rregullohen sipas:	
1.Udhëzimit Administrativ MMPH- Nr. 11/19 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesës së Ndërtesës	
2.Udhëzimi Administrativ MMPH- Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës dhe	
3.Udhëzimi Administrativ MEA- Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.	

Neni 5
Drejtoria për Buxhet e Financa

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Dhënia e certifikatave	
1.1.Dhënia e Certifikatave mbi gjendjen ekonomike;	2

2. Taksa për Automjetet Motorike	
2.1. Për automjetet që peshon deri në 3.5ton.	10-15
2.2. Për automjete mbi 3.5 ton.	20-30

Neni6
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Emërtimi dhe përshkrimi dokumenteve	
1. Për pije alkoolike	
1.1 Taksë vjetore për lejimin e përdorimit te pijeve alkoolike për hotele dhe motele;	60
1.2. Taksë vjetore për lejimin e përdorimin te pijeve alkoolike për Kafiteri dhe restorante dhe ne lokale te ndryshme ;	20
2. Taksa për pagese për pune jashtë orarit te rregullt	
2.1 Taksa për një ore pune te veprimtarive tregtare	5
2.2. Taksa për një ore pune te veprimtarive hoteliere	10
2.3. Taksa për një ore pune te veprimtarive zejtare	5
2.4. Taksa për një ore pune te veprimtarive shërbyese	10

Neni 7
Drejtoria për Arsim

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Participimet për vijim të fëmijëve në kopshte	
1.1. Participimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Istog,	30
1.2. Participimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Gurrakoc dhe Banjë;	25
1.3. Participimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Vrellë dhe Rakosh.	20
2. Participim për mësimin joformal	
2.1. Për regjistrim të vitit;	100
2.2. Për vijimin e mësimit praktik;	50
2.3. Për provimet përfundimtare të klasave-certifikatë;	30
2.4. Për diplomë të përfundimit të shkollimit;	20
2.5. Provimi diferencial	10
3. Pagesat për dokumentacionit shkollore	
3.1. Pagesa për nxjerrjen e diplomës duplikat;	1
3.2. Pagesa për nxjerrjen e dëftesës duplikat;	1
3.3. Certifikata për kryerjen e ciklit fillor 1–5 duplikat;	1
3.4. Certifikata për kryerjen e nivelit 6–9 duplikat;	1
3.5. Certifikata për kryerjen e arsimit të obliguar duke i përfshirë dy nivelet 1–9 duplikat;	1
3.6. Vërtetimet e ndryshme të cilat i kërkojnë ish nxënësit (palët) si në	1-0

arsimin e obliguar ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë;	
3.7. Për dëftesat e lëshuara kandidatëve që kanë të kryer shkollimin e obliguar sipas sistemit të vjetër të arsimit.	1-5

Neni 8
Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport

1. Shfrytëzimi i hapësirës në Sh.K. "Adem Jashari"	
1.1. Salla e madhe e koncerteve fitimprurëse për një mbrëmje;	200
1.2. Holli për mbrëmje rinore (një natë);	50
1.3. Salla e gjelbërt (për një ditë);	10
1.4. Anëtarësimi në bibliotekë për nxënës deri ne klasën e nëntë.	2
1.5. Anëtarësimi në bibliotekë për të gjithë të tjerët.	3
1.6 dhënia ne shfrytëzim e hapësirave rreth shtëpisë se kulturës m ^{2} mujore	3
1.7 dhënia ne shfrytëzim e zyrave ne shtëpinë e kulturës m ^{2} mujore	1.5
2. **Shfrytëzimi i tereneve dhe hapesirave rekreative-sportive;(me pak se nje vit)**	
2.1 Dhënia ne shfrytëzim e palestrës se sporteve - mujore për klubet e licencuara të Komunës se Istogut	0
2.2 Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth sallës se sporteve m ^{2} mujore për klubet e licencuara të Komunës se Istogut	0
2.3 Dhënia ne shfrytëzim e stadiumit te qytetit - mujore për klubet e licencuara të Komunës se Istogut	0
2.4 Dhënia në shfrytëzim e palestrës së sporteve - për një orë	15
2.5 Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth sallës se sporteve m ^{2} mujore	3
2.6 Dhënia në shfrytëzim e stadiumit te qytetit - për një orë	30

Neni 9
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve të shërbimit	Shuma €
1. Lëshuarja e vërtetimeve dhe shkresave të ndryshme nga Drejtorati	
1.1. Vërtetim për lirim nga participimi; te hiqet	1
1.2. Vërtetim për arsyetimin e shpenzimeve të varrimit për botën e jashtme;	3
1.3. Pëlqimi sanitar për licencim të ordinancave private; hiqet	10
1.4. Kërkesa të ndryshme të palëve;	1
1.5. Vërtetimi që nuk kanë sigurim shëndetësor në Kosovë;	3
1.6. Raport për inspektimin sanitar; te hiqet	10
1.7. Leje për Ekshumimin e Kufomave.	50
2. Çmimorja e bashkë pagesave për shërbime shëndetësore në nivelin parësorë,sipas Udhëzimit Administrativ 4/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë	
2.1. Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostiko me aparaturë;	1
2.2. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të familjes;	2

2.3. Ekzaminimi specijalistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut Familjar;	5
2.4. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	6
2.5. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike;	0.30
2.6. Ultrazëri standard;	2
2.7. Radiografia;	2
2.8. EKG;	0.50
2.9. Analiza laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina;	1
2.10 Analiza laboratorike komplet;	3
2.11. Caktimi i sheqerit në gjak në glikometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimev shëndetësore;	1
2.12. Audiograma;	1
2.13. Shpëlarja e veshit;	1
2.14. Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.15. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.16. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës, vetëm në vizitën e parë;	3
2.17. Trajtimi ditor me infuzione në institucione shëndetësore;	1
2.18. Certifikata Shëndetësore (CM0101) Për regjistrim të fëmjëve në çerdhe dhe kopshte	10-0
2.19. Certifikata Shëndetësore (CM0102) Për regjistrim në shkolla fillore,të mesme të larta fakultete dhe nivele tjera të shkollim	10-0
2.20. Certifikata Shëndetësore (CM0201) Për punësim	15
2.21. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	5
2.22. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për shtetasit e huaj;	25
2.23. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive për1 orë;	25
3. Çmimorja e pagesave për shërbime stomatologjike të nivelit parësor-QKMF të Komunave dhe QMF	
3.1. Vizita e parë stomatologjike;	1
3.2. RTG i dhëmbit;	1.50
3.3. Mbushja e përhershme me amalgamë;	4
3.4. Mbushja e përhershme me kompozitë;	5
3.5. Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.6. Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.7. Extirpimivital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.8. Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.9. Extirpimimortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6

3.10. Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.11. Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme;	6
3.12. Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës;	1
3.13. Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave;	1
3.14. Vulosja e fisuarave;	1
3.15. Mënjanimi i depozitimeve të buta;	1
3.16. Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull);	3
3.17. Kiretazha e xhepave paradental (një dhembë);	1
3.18. Nxjerrja e dhëmbit;	1.50
3.19. Incizoni infra dhe extra oral;	1.50
3.20. Heqja e kurorës me anë të prerjes;	1
3.21. Riparimi i protezës.	1.50
4. Shfrytëzimi i Autoambulancës me kërkesë të klientit pa referim të mjekut e që nuk janë raste Emergjente	
4.1. Relacioni Istog-Pejë;	10
4.2. Relacioni Istog-Prishtinë;	30
4.3. Relacioni Istog-Tiranë;	100
4.4. Relacioni Istog-Shkup;	100
5. Çmimorja e Pagesave për Shërbime në Qendrën Sociale	
5.1. Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e Veprimit e vlefshme për 1 vit;	2
5.2. Konstatimi që nuk ka obligime ligjore(Alimentacion) ndaj personave përgjegjës ligjor (për heqje të Nënshtetësisë të Republikës së Kosovës);	10
5.3. Konstatimi që posedon mjete material për ekzistencë (për marrje të nënshtetësisë të Republikës së Kosovës);	10
5.4. Pëlqim për bashkim familjar në botën e jashtme.	10
5.5. Certifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim hiqet	10
5.6. Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për armëmbajtje;e re	20
5.7. Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmës sociale e re	5

Neni 10
Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Shërbimet/aktivitetet	Shuma €
1. Lejet për ndërhyrje në infrastruktura dhe hapësira tjetër publike	
1.1. Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për $1m^2$;	50
1.2. Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve, kubzave të betonit,	25

beton etj për $1m^2$.	
2. Shërbime tjera	
2.1. Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thëngjilli etj . në hapësirat publike për 24 orë.	10
3. Leje për bllokim të rrugës (shiritit rrugor-trotuarit)	
3.1. Zona urbane-12 orë;	20
3.2. Zona urbane-24 orë;	25
3.3. Leja për ndalje(ngarkim shkarkim)të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 ditë;	10
3.4. Leja për ndalje(ngarkim shkarkim)të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 muaj;	20
3.5. Leja për ndalje(ngarkim shkarkim)të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni për 1 vit;	80
3.6. Leje për auto taxi 4+1 ulëse, për 1 vit;	50
3.7. Leje për kombi bus 8+1 ulëse (Leje e veçanet për transportin e nxënësve të mësimit fillor), për 1 vit;	60
3.8. Ndërrimi i Lejes për auto-taxi (nënkuptohet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të Lejes që është pajisur me parë);	10
3.9. Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtareve dhe për transport të veçanet, Operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion-nisje të caktuar);	25
4. Lejet për automjetet e renda transportuese me peshë prej 3.5-7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në ato rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar.	
4.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	10
4.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	20
4.3. Leje e lëshuar për një muaj;	30
4.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here.	80
5. Lejet për automjetet e renda transportuese me peshë mbi 7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në ato rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar;	
5.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	15
5.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	25
5.3. Leje e lëshuar për një muaj;	40
5.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here;	100
6. Parkingje publike shiritore	
6.1. Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuar-tarifa mujore për persona fizik;	5-30
6.2. Për persona juridik, mujore	10-50
7. Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për rrugë lokale dhe zona urbane	
7.1. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, pa shirita qarkullues përcjellës;	10
7.2.Vërtetime të ndryshme(Certifikata mbi kryerjen-moskryerjen e shërbimit ushtarak)	5
7.3. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, me shirita qarkullues përcjellës.	40

Neni 11
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

1. Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1.1. Vlerësimi i dëmeve ne Bujqësi dhe Pylltari	10-0
1.2. Pëlqim nga komuna përshfrytëzim dhe seperacionte burimeve minerale; bazuar ne ligjin nr.03/L-163 neni 31 nënparagrafi 1.13	50
1.3. Taksë për ndërrimin e destinimit të tokës sipas klasave sipas UA 2006;	I-IV-1€/m^2 V-VII-0. 75 €/m^2 VII-VIII-0. 50 €/m^2
1.4. Certifikatë shëndetësore sipas llojit te kafshëve të përcaktuar sipas Urdhëzimit. Administrativ . (**MBPZHR) NR.14/2014 për qarkulimin e kafshëve Gjalla Brenda Territorit të Kosovës të datës 22.05.2014**	20% nga shuma e përcaktuar me UA
Kompenzimi per caktimin e çmimeve - taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore- drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale - teknike behet sipas Udhëzimmit administrativ MA– nr 12/2005 **Për caktimin e çmimeve - taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe për shërbime profesionale – teknike** **1.5.SHëRBIMET PROFESIONALE PëR PRERJE Të PYJEVE PRIVATE:**	
1.5.1 Dru zjarri për m3	1.5
1.5.2. Dru zjarri mbi 7 m3	2.00
1.5.3. dru Teknik m3	2.5
1.6. Taksa për kullotjen e bagëtisë (për një (1) vit):	
1.6.1 Gjedhe mbi një vjet copë	1.20
1.6.2. Viçat copë	0.80
1.6.3. Delet copë	1.20
1.6.4. Qengjat copë	0.80
1.6.5. Kuajt dhe Gomarët copë	1.90
1.6.6. Derrat copë	1.60
1.6.7. Derrkuca copë	0.90
1.7. Vërtetim për veprimtari bujqësore;	5
1.8. Te hyrat nga pylltaria ne baze te Ligjit Nr.03/L-153 te datës 25.02.2010 dhe Çmimores për prodhime pyjore;	30% nga të Hyrat
1.9 Dhënia ne shfrytëzim te tokës bujqësore 1000 m^2 - mujore (10 ari)	(0.80)

Neni 12
Gjobat

1. Sipas nenit 63 të Ligjit për Gjendjen Civile me Nr. 04/L-003 të vitit 2011, për këtë gjobitet personi për këto shkelje;

1.1. prej njëzet(20) deri pesëdhjetë (50) euro ku nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me ligj;

1.2. prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

1.3. prej njëzet(20) deri pesëdhjetë (50) Euro kush kryen varrimin pa leje;

2. Gjobat e shqiptuara për kundërvajtje në trafik i takojnë Komunës. Alokimi i mjeteve të arkëtuara bëhet sipas dispozitave të rregullave të thesarit. Mjetet e arkëtuara mund të jenë si rrjedhojë e arkëtimit nga dënimet mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog.

3. Për mospagimin e taksave dhe ngarkesave të përcaktuara në këtë rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, për te cilat ka fatura do te inicohet procedura përmbarimore.

4. Për gjobat mandatore zbatohen Ligjet – udhezimet administrative dhe rregulloret komunale në fuqi.

5. Për mbrojtjen e mjedisit zbatohen gjobat mandatore sipas Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 i miratuar nga MMPH.

6. Për të gjitha kundërvajtjetqë shkaktohen nga personat fizik apo juridik, sanksionet janë te parapara sipas Ligjit për Kundërvajtje Nr.05/L-087, (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës nr/33-2016).

Neni 13
Afati

1. Afati për pagesën e të gjitha gjobave gjegjësisht dënimeve të shqiptuara është 15 (dite) ditë nga dita e shqiptimit të dënimit nga ana e inspektorit.

2. Në rast se përfaqësuesi i subjektit afarist nuk e bënë pagesën në afatin e caktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndaj tij do të iniciohet procedura kundërvajtësve pranë Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog.

Neni 14
Mbikëqyrja dhe Zbatimi

Kryetari i Komunës është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 15
Lirimi nga pagesa e taksave

1. Bazuar në nënparagrafin 1.8 të paragrafit 1 të nenit 8 dhe nënparagrafin 1.13 të paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit Nr.04/L-054për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Viktimave Civile dhe familjeve të tyre, nga taksat administrative komunale lirohen:familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së dhe Invalidët e UÇK-së.

2. Nga pagesa e taksave për kryerjen e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë, nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhënia e Certifikatave mbi gjendjen ekonomike, dhe Vërtetimeve për tatimin në pronë, lirohen: familjet e viktimave civile të luftës, veteran të luftës, pensionistët, shfrytëzuesit e ndihmës sociale, personave me aftësi të veçanta dhe studentët (të gjitha ato kategori që parashihen me legjislacionin në fuqi) .

3. Personat e verbër lirohen nga pagesa e të gjitha taksave komunale që i parasheh kjo Rregullore, bazuar në nenin 6 të Ligjit për personat e verbër Nr.04/L-092 të vitit 2011.

4. Kategoritë e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk lirohen nga dënimi me gjobë sipas nenit 63 të Ligjit për Gjendjen Civile me Nr. 04/L-003 të vitit 2011.

5. Nga pagesa e taksës për parashtrimin e kërkesave të përcaktuara me nenin 2, paragrafi 5 dhe nënparagrafin 5.1 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përfaqësuesit e komuniteteve të cilët parashtrojnë kërkesë në interes të komunitetit, të gjithë ata që parashtrojnë kërkesë për ndihmë shëndetësore, për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, ndihma dhe vërtetimet për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore dhe të tjera, si dhe kërkesat për ndihma tjera.

6. Nga pagesa e taksës të përcaktuar me nenin 6, paragrafi 4 dhe nënparagrafin4.1 lirohen personat fizik dhe juridik për organizimin e koncerteve për qëllime humanitare.

7. Personat të cilët u përkasin kategorive të lartcekura janë të obliguar që të sjellin dëshmi përkatëse për tu liruar nga pagesa.

8. Nga pagesa e taksave sipas nenit 3 paragrafi 5 i kësaj Rregulloreje lirohen OJQ jo fitim prurëse dhe organizatat humanitare.

Neni 16
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores komunalepër Taksat Ngarkesat dhe Gjobat Nr.8/2020.

Neni 17
Hyrja në fuqi


Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tije në faqen zyrtare të Komunës, sipas nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040.

Kryetari i Komunës

z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës **Kuvendi Komunal Istog**

PLANI INVESTIV NË INFRASTRUKTURËN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT NË KOMUNËN E ISTOGUT



HIDRODRINI

SHUKOS

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE

IRD International Relief & Development

CDF

Maj 2011

Shkurtesat (akronimet):

- KK- Kuvendi Komunal,
- KRU- Kompania Regjionale e Ujsjellësit,
- SH.A- Shoqëri Aksionare,
- MPHM- Ministria e Planifikimit Hapsinor dhe Mjedisit,
- BE – Bashkimi Europian,
- GP- Grupi Punues.

Përmbajtja

Historiku i shkurter i Komunës……3
Pozita gjeografike ……..4
Pasuritë natyrore …...……...5
1.0 Hyrje
1.1 Sfondi 5
1.2. Roli dhe Përgjegjësitë e Komunës në Zhvillimin e Infrastrukturës Publike..... …….5
Burimet kryesore……..9
1.3. Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Ujësjellësit.....6
1.4. Arsyeshmeria e projekteve.....12
1.5. Fazat e Implementimit.....14
1.6 Çmimi përafërt dhe programi investiv në Ujësjellësa.....15

2.0 Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Kanalizimit.....15
2.1 Problemet.....17
2.2 Pasojat.....18
2.3 Kanalizimi i ujërave të zeza – koncepti i zgjedhjes.....18
2.4 Mos- funksionimet Kryesore.....13
2.5 Opcionet e Rrjetit të Kanalizimit.....23
2.6 Modelimi Hidraulik-Metodologjia.....24
2. 7 Kostot e Planifikimit të Rehabilitimit dhe Zgjerimit të Rrjetit të Kanalizimit.....24
3.0 Trajtimi i Ujërave të Zeza për Qytetin e Istogut (Krahasimi teknik-ekonomik dhe mjedisor si dhe zgjedhja e Opsioneve)**.....24**
3.1 Alternativat e Trajtimit të Ujërave Urbane.....24
3.2 Teknologjia e Impiantit të Trajtimit të Ujërave urbane.....25
3.3 Konkluzionet për alternativën 2.....25
3.4 Përfitimet e projektit.....29
4.0 Konkluzione dhe Rekomandime 30
Referencat ……...31

Historiku i shkurtër i Komunës

Në bazë të të dhënave arkeologjike,lokaliteti i Istogut përmendet dhe daton qysh nga koha antike,sipas disa burimeve historike thuhet se në pjesën e teritorit në mes të Istogut të madh dhe të vogël ku bashkohen lumi i Istogut dhe lumi i Qaushit. Ka ekzistuar një koloni romake gjë që i përket lokacionit të sotëm të qytetit, poashtu Istogu përmendet si lokacion edhe ka fundi I shek. XIV kur kjo pjesë e Dardanisë ishte nën pushtimin sllav. Gjatë kohës së sundimit turk, Istogu si vendbanim njifet me zhvillimin e mullinjëve për bluarjën e drithit si dhe punëtorive për perpunimin e leshit(zhgunit)

Me dekretligj nga 30 Prilli I vitit 1942 Istogu u shpall Qytezë,në rrethin e Istogutdhe krahas funksionit ekonomik të atëhershëm,istogu në bazë të këtij dekretligji, fiton edhe funksionin administrative. Me 29 Dhjetor të vitit 1978,Istogu shpallet Qytet me siperfaqe të cakuar sipas planit urbanistik. Lokalitete të urbanizuara janë edhe Banja dhe Gurrakoci.



Pejsazh nga Qyteti i Istogut




Istogu në vitin 1935

Pozita gjeografike

Komuna e Istogut ka një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe është e hapur në të gjitha anët me përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar me male të larta, Bjeshkë të thata dhe Mokna me një lartësi mbidetare deri në 2155 m (Mokna) dhe është e lidhur me rrugë të asfaltuara me të gjitha komunat e Kosovës.

Klima në këtë zonë ka karakter kotinental dhe karakter bregdetarë, por kryesisht dominon karakteri kontinental. Temperatura mesatare e vitit është rreth 10.7 ^{0} C . Muaji më i ftohtë është muaji Janar me temperature mesatare -10 ^{0} C . Lëvizja e ajrit ndikon në mënyrë të theksuar nga relievi, për këtë arsye shpejtësia e erës shpeshher arrinë gjerë në 120 km/h.

- Istogu shtrihet në anën veri-perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit
- Istogu kufizohet me këto komuna: Pejë,Klinë, Skenderaj, ZubinPotok, Tutinë(Serbi), Rozhajë (M.i Zi).
- Komuna e Istogut ka dhjetë bashkësi territoriale(vendbanime)
- Komuna e Istogut posedon siperfaqe prej 454 km² , me një lartësi mbidetare 350-400m (fusha), ndersa lartësia më e madhe është 2155 m(Mokna).
- Me rexhistrimin e vitit 1981 Istogu kishte 50.011 banorë. Sipas vlerësimit në vitin 2007 vlerësohet të jenë 60.000 banorë, ku kryesisht dominon popullësia e moshës së re me një % të lartë.



Pasuritë natyrore

Komuna e Istogut është e pasur me begatit natyrore të cilat paraqesin bazë objektive për zhvillimin e përshpejtuar të kësaj treve. Begatinë sipërfaqësore e shënojnë sipërfaqet e tërësishme të tokës në një sipërfaqe prej 45.384 ha, ku prej tyre 22.879 ha janë tokë bujqësore, pyje janë 19.220 ha dhe të tjera 3285 ha. Teritori i komunës së Istogut është i pasur me ujëra sipërfqësorë, nëntokësorë dhe termal. Komunën e Istogut e përshkojnë lumenjtë Drini i bardhë, lumi i Istogut, lumi i Vrellës, Kujafqi dhe Qaushi. Në Banjën Ilixha gjëndet uji termomineral me një kapacitet prej 17.5 l/sec dhe me një temperaturë prej 46^0 – 48^0 C ku janë të ngritura kapacitete për pushim dhe rekreacion që janë specializuar për shërimin e shumë sëmundjeve reumatike dhe sëmundjeve tjera të ndryshme. Pasuritë natyrore nëntokësore janë mermeri (Onix) në Banjë, i cili në kohën e tashme nuk eksploatohet më, si dhe thëngjilli (linjit) në fshatin Tuqep. Bujqësia është degë e zhvilluar në komunën e Istogut sepse këtë e mundëson kualiteti i mirë i tokës bujqësore si dhe mundësia e ujitjës së sipërfaqeve tokësore nga lumenjtë që e përshkojnë këtë territor. Komuna e Istogut posedon kushte të përshtatshme për kultivimin e peshkut, ku kryesisht kultivohet peshku (trofta e Kalifornisë), kapacitetet prodhuese të peshkut janë të ndërtuara në Istog dhe Vrellë.

V I Z I O N I

"Istogu do të jetë qytet I pastër dhe I këndshëm për jetesë, qytet i cili do të ndërtohet sipas planit modern urbanistik. Istogu do të ndërtoj një infrastrukturë të përshtatshme dhe do të krijojë kushte të mira për rritjën e shpejtë të biznesit privat dhe atë kryesisht në sektorin e bujqësisë, turizmit dhe prodhimit të peshkut. Qeveria lokale do të bashkëpunojë me sektorin privat dhe do të jetë shumë aktive dhe e inkuadruar drejt rritjës ekonomike, më qëllim të zvoglimit të nivelit të papunësisë dhe rritjës së standardit të jetesës për popullatën e Istogut.

1.0 Hyrje

1.1 Sfondi…….

Me iniciativën e USAID- it, respektivisht IRD dhe SHUKOS-it, me Kuvendin Komunal-Istog dhe KUR "Hidrodrini" Sh.A. ka marrë përsipër që të punojë në përgatitjen e një dokumenti përmbledhës për investimet e nevojshme në infrastrukturën e ujësjellësit, ujërave të zeza, në komunën e Istogut. Puna ka qenë ekipore e bazuar në parime të pjesëmarrjes aktive të të gjithë anëtarëve të grupit (Ujësjellësit dhe Kuvendit Komunal-Istog), me ç`rast angazhimet specifike të secilit anëtarë janë përcaktuar konform kualifikimeve përkatëse të tyre dhe eksperiencës profesionale.

1.2. Roli dhe Përgjegjësitë e Komunës në Zhvillimin e Infrastrukturës Publike

Menaxhimi i sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në komunën e Istogut, bëhet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit „Hidrodrini" e cila është e licensuar për këtë qëllim. Ndërkaq menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut bëhet nga Komuna e Istogut përmes kontraktorëve të jashtëm.

Duke pasur parasyshë rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit, ujërave të zeza, dhe ujërave të shiut për kualitetin e jetës, mirëqënien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, padyshim që komuna ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, dhe po ashtu edhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza. Rrjedhimisht planet zhvillimore dhe urbanistike të komunës duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin e saj administrativ.

Në këtë kontest, grupi punues, është udhëhequr nga parimi që projektet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza që janë përfshirë me këtë projekt-propozim të jenë rezultat i konsultimeve me KUR „Hidrodrini“ dhe të korrespondojnë me planet investive të kësaj kompanie duke qenë po ashtu në korelacion me planet zhvillimore të komunës së Istogut.

Në anën tjetër infrastruktura e kanalizimit të ujërave të shiut është përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e Komunës, për të cilën nuk ekziston një kompani publike e as departament komunal i veçantë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtjen e saj. Si pasojë e saj mungojnë pasqyra e plotë e gjëndjes ekzistuese dhe projektet e planifikuara, kështu që GP (grupi punues) me rastin e hartimit të projekteve të propozuara për këtë infrastrukturë është bazuar në të dhënat nga Komuna Istog dhe Kompania e Ujësjellësit.

1.3 Gjëndja Ekzistuese e Infrastrukturës së Ujësjellësit


Programi i infrastrukturës – Furnizimi me ujë dhe kanalizimi, synon rehabilitimin dhe rindërtimin e qëndrueshëm të infrastrukturës në Kosovë. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i organizuar, teknik dhe financiar i shërbimeve komunale të ujit në bazë të principeve të ekonomisë së tregut.

Në kompanitë e ujit Hidrodrini në Njësinë e Istogut, ofrimi i shërbimeve konsumuese të besueshme sa i përket mbulimeve të shpenzimeve dhe të operimit të shërbimeve komunale si kompani efikase do të ilustrohet me shembuj. Ky raport merret vetëm me elementet e projektit që përqëndrohen në përcaktimin e vlerave në Istog. Raporti përfshinë rezultatet dhe përfundimet e studimeve në terren.


Sistemi i ujësjellësit të Istogut e merr ujin nga burimi i Istogut, Javorit, Vojdullit, Vrellës, si dhe një pjesë e furnizimit bëhet nga burimi i Drinit të Bardhë. Kapaciteti i të gjitha burimeve është Q= 20.380 m3/ditë. Në tabelë janë paraqitur fshatrat të cilat shërbehen me ujë të pijshëm.










Burimi i Istogut, Penda


Burim Vrellë
Fshatrat-Kaliqan dhe Oroberde
Vrellë
Studenicë
Kaliqan
Te Mal
Orobërdë
Prigodë
Lubovë


Burim Javor 1 dhe 2
Fshatrat, Cërkolez dhe Syriganë
ø90mm
ø110mm
Uçë
Syrigonë
Cërkolez
Banja





Sistemi Ujësjellësit dhe burimeve

Burimet kryesore

Njësia e Istogut			
Nr.	**Emri i burimeve**	**Kapaciteti-m3/ditë**	**l/s**
1	**Istogu**	**29,376**	**340**
2	**Javori**	**0.508**	**5.87**
3	**Vojdulli**	**0.827**	**9.57**
4	**Vrella**	**2,505**	**29**

Gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyet kryesore për probleme të tilla konsistojnë në faktin se humbjet e ujit në sistemin e transmisionit dhe në sistemin distributiv janë në një shkallë jashtëzakonisht të lartë–rreth 60%. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Pra ato përfshijnë humbjet komerciale dhe humbjet fizike/teknike. Proporcioni i këtyre dy kategorive të humbjeve nuk dihet saktësisht por vlerësohet të jetë 50%/50%. Faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e lartë të humbjeve vlerësohet të jenë: (rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kyçjet ilegale, mos-matja e saktë e ujit).


Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit, në formën që në burimet e ujit ekzistojnë stacionet e klorimit ku klorohet uji konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Sistemi i furnizimit me ujë është i ndarë në 2 zona: (I) zona e epërme, që furnizohet me ujë përmes sistemit të pompimit, dhe (II) zona e poshtme, që furnizohet me ujë me rrjedhje me gravitacion.

2	Istog i Poshtëm	Istogut	Istog	1550	255	24
3	Dushkajë	Istogut	Istog	500	90	24
4	Lluga	Istogut	Istog	887	143	24
5	Drogolevc i	Istogut	Istog	700	34	24
6	Serbobran	Istogut	Istog	290	47	24
7	Llukavci i Begut	Istogut	Istog	940	147	24
8	Muzhevinë	Istogut	Istog	1014	157	24
9	Tomoc	Istogut	Istog	2134	274	24
10	Gurakoc	Istogut	Istog	3769	685	24
11	Prekallë	Istogut	Istog	646	86	24
12	Drogolevc i epërm	Istogut	Istog	420	62	24
13	Dubravë	Istogut	Istog	1280	231	24
14	Bellopojë	Istogut	Javor	560	73	24
15	Uçë	Istogut	Javor	1653	2130	24
16	Shushicë	Istogut	Javor	2110	398	24
17	Zhakovë	Istogut	Javor	594	25	24
18	Rakoshë	Istogut	Javor	1399	203	24
19	Vrellë	Istogut	Vrellë	3921	549	24
20	Stupe	Istogut	Vrellë	420	47	24
21	Temal	Istogut	Vrellë	612	47	24
22	Oroberdë	Istogut	Vrellë	810	134	24
23	Studenicë	Istogut	Vrellë	1952	292	24
24	Kaliqan	Istogut	Vrellë	1260	228	24
25	Dubovë e Vogël	Istogut	Drini i bardh	442	61	24
26	Bajicë	Istogut	Drini i bardh	904	89	24
27	Banjë	Istogut	Drini i bardh	1829	448	24
28	Llukavc i Thatë	Istogut	Istogut	247	34	24
29	Kovragë	Istogut	Istogut	1170	155	24
30	Dobrushë	Istogut	Istogut	1550	470	24
31	Kashicë	Istogut	Istogut	732	122	24
32	Saradran	Istogut	Istogut	2150	370	24
33	Trubuhoc	Istogut	Istogut	1260	212	24
34	Zabllaq	Istogut	Istogut	632	92	24
35	Zallq	Istogut	Istogut	720	144	24
36	Drejë	Istogut	Istogut	658	98	24
37	Shalnavicë	Istogut	Istogut	120	20	24
38	Osojan	Istogut	Istogut	260	116	24
39	Veriq	Istogut	Istogut	620	92	16
40	Lubov II	Istogut	Drini i bardh	160	32	24
41	Prigodë	Istogut	Istogut	712	132	24
42	Cercë	Istogut	Istogut	1860	367	24
43	Lubozhdë	Istogut	Istogut	1250	249	24
44	Corrollukë	Istogut	Drini i bardh	684	113	24
45	Oroberd	Istogut	Vrellë	510	85	24
46	Syne	Istogut	Istogut	530	104	24
47	Lubovë I	Istogut	Drini i bardh	542	82	24
48	Gjithsejtë			55719	11216	

Në kuadër të furnizimit apo të prodhimit të ujit të pijshëm në Njësinë Operacionale në Istog janë këto asete:

- Tetë Depo (Rezervuare) të ujit me kapacitet 700m^3, 400m^3, 400m^3, 800m^3, 500m^3, 200m^3, 400m^3, 400m^3,
- Tetë stacione të pompimit,
- Pesë stacione të klorimit
- Një rrjetë prej 320 km të dimensioneve prej Ø50 deri në Ø400 gypësjellës të ujit.



Sistemi i Ujësjellësit, gjendja ekzistuese

Vendbanimet e furnizuara me Ujë nga sistemi i Ujësjellësit.

Vendbanimet të cilat duhet të furnizohen me ujë të sistemit. Projekti për furnizim me ujë nga Burimi I Istogut është në në fazën finale të realizimit

1	Surigon	Istogut	Vazhdimësi	620	205	-
2	Cerkolez,	Istogut	Vazhdimësi	440	71	-
3	Kerninë, I dhe II	Istogut	Vazhdimësi	780	98	-
4	Padalishtë.	Istogut	Vazhdimësi	612	92	-
5	Mojstirë	Istogut	Vazhdimësi	680	93	-
6	Gjithsejt			3132	559	

1.4Arsyeshmëria e projekteve

Emri i projektit:		**Reduktimi i humbjeve teknike, projekti bazë i zgjerimit të rrjetit. (Implementimi i zonave të matura – DMA në rrjetin ekzistues)**
Faza e Pare:		**01**
Lokacioni:		Projekti do të implementohet në zonën urbane të qytetit të Istogut
Kostoja:		Kostoja totale: **400,000€;**
Përshkrim i shkurtër i projektit:		Sipas të dhënave të marra nga KUR ”Hidrodrini” një kompani konsulente e përfshirë në një projekt të financuar nga KFW, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të ujit në kompanin e ujit, së bashku me stafin e Hidrodrinit, kanë projektuar krijimin e zonave të matura – DMA për zonat urbane të Istogut. Projekti përfshinë ndërtimin e 15 pusetave për ujëmatës zonal, me të gjitha fitingjet e nevojshme. Projekti do të implementohet në zonën urbane të qytetit të Istogut. Rreth 70% të klientëve të furnizuar nga Hidrodrini, njësia Istog, janë të koncentruar në zonën urbane të qytetit të Istogut. Kjo pjesë konsiderohet si pjesë e rrjetit me humbje më të larta të ujit në Hidrodrin, pasi që humbjet në këtë pjesë arrijnë vlerën prej 70%. Furnizimi total me ujë në zonën urbane të qytetit të Istogut është rreth 610.000m^3/muaj. Duke u bazuar në shkallën e humbjeve të ujit prej 70%, aktualisht vetëm rreth afërsisht 160.000m^3/muaj faturohet. Pas zvogëlimit të humbjeve dhe zgjerimit të shërbimeve të ujit, është e mundshme që të mbulohen investimet në një afat prej 6 muajsh.
Përfitimet:		Me zvogëlimin e humbjeve prej 70% në 40%, njësia e Hidrodrinit do të jetë në gjëndje që të kursej rreth 85,000m^3/muaj ujë shtesë, duke mundësuar zgjërimin e shërbimeve të ujit në zonat tjera, në të cilat zona banorët vazhdojnë që të konsumojnë ujin nga puset.
Emri i projektit:		**Rehabilitimi i rrjetit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut, rehabilitimi i sistemit të pompave të sistemit të ujit, si dhe shtimi i sasisë së ujit në burimet e Vojdullit dhe Moknës.**
Faza e Dytë :		**02**
Kostoja:		Kostoja totale: **950.000 €,**
Përshkrim i shkurtër i projektit:		Projekti përfshinë rehabilitimin e sistemit ekzistues të ujësjellësit të Istog-Gurrakocit, Istog-Cerrcës, Lubozhdës, Prigodës, Istog-Kovragës, Veriqit, Dubravës dhe Synesë. Rehabilitimi i sistemit të pompave kryesore të sistemit të

		ujit, si dhe shtimi i sasisë së ujit në burimet e Vojdullit dhe Moknës. Bazuar në humbjet e ujit në rrjetin primarë dhe atë sekondarë, për shkak të vjetërsisë së gypave(gypat e azbestit dhe gypat e metalit) si dhe gabimeve teknike në disa sisteme të fshatrave të komunës së Istogut, është i domosdoshëm rehabilitimi i rrjetit të sistemit të ujit të pijshëm, si dhe pastrimi burimeve, të Moknës dhe Vojdullit. Si dhe rehabilitimi apo zëvendësimi i pompave ekzistuese, për shkak të optimalizimit të energjisë elektrike, si dhe rritja e kapacitetit të disa pompave. Projekti do të implementohet në faza të caktuara si më poshtë, varesisht nga buxheti. Vetëm në qytetin e Istogut, pra në sistemin kryesor, duhet rehabilituar rrjetin e sistemit në 6 segmente: Rehabilitimi i gypit: • Ø 300, L=850m, Burim - Qendër. • Ø 250, L=1000m, Qendër – Istog i Poshtëm. • Ø 250, L=5000m, Istog i Poshtëm – Tomoc. • Ø 160, L=2150m, Qendër – Sheshi i Gjakut. • Ø 100, L=2300m, Zona e epërme-Bytyqi, Blakaj, Bujupaj. • Ø 110, L=200m, Centrali – ana e krahut të Spitalit. Nëpërmjet këtij projekti do të përfitojnë rreth 28.000 banorë, ose rreth 4.500 amvisëri.
Përfitimet:		Duke e rehabilituar rrjetin e furnizimit me ujë, shtimin e sasisë së ujit, si dhe rehabilitimin e pompave, njesia gjegjësisht kompania e ujit do të rrisë kualitetin e furnizimit me ujë, do të reduktoj humbjet e ujit si dhe do të reduktoj shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit dhe reduktimet e shpenzimit te energjisë elektrike.
Emri i projektit:		**Rrjeti i zgjërimit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut.**
Faza e Tret :		**03**
Kostoja:		Kostoja totale: 2**50.000 €,**
Përshkrim i shkurtër i		Projekti përfshinë ndërtimin e gypaconit të ri dhe ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë, me diametra dhe gjatësi të ndryshme të gypit.

projektit:		Bazuar në politikat e Kuvendit Komunal të Istogut dhe Kompanisë së Hidrodrinit, ekziston sasi e mjaftueshme e ujit për të furnizuar këto fshatra. Rrjeti furnizues për këto fshatra do të kyçet në rrjetin ekzistues të sistemit apo në burimet alternative të ujit në burimet e Istogut i cili do të furnizohet përmes gravitetit apo të sistemit të pompimit. Projekti do të implementohet në fshatrat e komunës së Istogut: Surigon, Cerkolez, Kernin, Padalisht dhe Mojstir. Banorët e këtyre fshatrave janë duke u furnizuar me ujë nga puset, të cilat sipas Institutit të Shëndetësisë Publike në Prishtinë, uji nuk i plotëson standardet e ujit të pijshëm, pasi që përmban ndotje bakteriologjike, duke paraqitur në këtë mënyrë rrezik për shëndetin e banorëve që jetojnë në këto fshatra. Mjaft shpesh në këto zona janë shfaqur edhe raste epidemiologjike. Nëpërmjet këtij projekti do të përfitojnë rreth 2.540 banorë, ose rreth 560 amvisëri.
Përfitimet:		Duke e zgjeruar rrjetin e furnizimit me ujë, kompania e ujit do të rrisë numrin e klientëve, dhe si rezultat do të rrisë të hyrat e veta, ndërsa në anën tjetër banorët do të furnizohen me ujë të pijshëm, ashtu që komuna do të permbushë programin investiv të infrastrukturës së furnizimit me ujë.

1.5Fazat e Implementimit

Programi i propozuar investiv për zgjerim të rrjetit si dhe reduktim të humbjeve ndahet në tri faza kryesore:

Faza 1: Implementimi i zonave të matura – DMA në rrjetin ekzistues, me **400.000 €**, sigurimi dhe furnizimi me material, punët do ti implementoj KUR"Hidrodrini" – Pejë – Njësia Istog.
Faza 2: Rehabilitimin e sistemit ekzistues te ujësjellësit të Istogut, Lubozhdës, Prigodës, Kovragës, Veriqit, Dubravës dhe Gurakocit, rehabilitimi i sistemit të pompave kryesore të sistemit të ujit si dhe kaptimi i burimeve te Moknës dhe Vojdullit. me **950.000 €,** çmimi me hartim të projekteve Detale (viti 2023-2028).
Faza 3: Rrjeti i zgjerimit të furnizimit me ujë për fshatrat e komunës së Istogut. Me **850.000 €,** çmimi me hartim të projekteve Detale (viti 2023).

1.6Çmimi i përafërt dhe programi investiv në Ujësjellësa

Në bazë të vlerësimeve të kryera nga GP, për të ofruar një sistem të besueshëm të furnizimit me ujë të pijes çmimet e rehabilitimit dhe zgjerimit duhët llogaritur përafërsisht në vlerë prej afërsisht, 2.0 milion Euro. Kjo i përgjigjet investimeve specifike prej ~35 Euro për banorë.

Masat e vlerësuara, duke mbuluar periudhën deri më 2015, janë ndarë në 4 faza, duke përfshirë tërë kapacitetin e gjëndjes së furnizimit dhe mundësitë e shpenzimeve të sigurta operacionale.

Fazat I.	**Çmimi (Euro)**
Faza 1 - Reduktim Implementimi i zonave të matura – DMA	400.000
Faza 3 – Rehabilitimi i pompave, pompat e reja për Banjë të Pejës si dhe shtimi i sasisë së ujit, si dhe rehabilitimi i sistemit, pompave dhe shtimi i sasisë së ujit	950.000
Faza 3 - Zgjerimi i fshatrave të mbetura.	850.000
Investimet për 3 Fazat	**1.900.000**
Inxhinieringu është i llogaritur	-
Shpenzimet e paparapara 5 %	70.000
Totali i Investimeve	**2.270.000**


Çmimet totale të rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit të ujsjellësit


2.0 Gjendja Ekzistuese e Infrastrukturës së Kanalizimit

Sistemi i kanalizimit për qytetin e Istogut është ndërtuar që nga viti 1972, në gjatësi 32 Km, si sistem i tipit të ndarë: sistem i veçantë për largimin e ujërave të zeza nga sistemi i largimit të ujërave të shiut. Rrjeti i kanalizimit ne fshatrat tjera të Komunës janë kryer kryesisht nga viti 2008 e deri në vitin 2022 në gjatësi prej rreth 90 Km. Të gjitha derdhjet e këtyre kanalizimeve janë pa trajtim adekuat të pastrimit ndotjeve.

Problemet kryesore që ka të bëjnë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në komunën e Istogut, janë: (I) mos-përfshirja e zonave rurale, (II) dimensionet jo-adekuate të rrjetit të vjetër (si pasojë e rritjës së popullatësnë disa zona urbane), dhe (III) Mungesa e grumbullimit të ujërave të zeza me Kolektorë dhe e impiantit për pastrim.

Harta e Kanalizimit i qytetit






Rrjeti

2.1 Problemet

- Mbledhja e pamjaftueshme e ujërave të zeza,
- Derdhja e ujërave të zeza pa trajtim,

Qyteti i Istogut ka vetëm rrjetin e kanalizimit fekal, përderisa mungon ai atmosferik. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve materiale në dispozicion. Si pasojë është se dimensionet e gypave janë joadekuat dhe në shumë vende sjellin probleme të caktuara. Gjithashtu, edhe mirëmbajtja e rrjetit është shumë i vështirësuar. Si në çdo vend në Kosovë edhe në këtë rast rol dominues në shpërndarjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terenit. Kështu të gjitha ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumin dhe prrojet e Istogut. Shkarkimi i ujërave të zeza bëhet pa ndonjë trajtim paraprakë duke e ndotur ujin e lumejve. GP ka paraparë sistem të ndarë të kanalizimit, gjegjësisht një rrjet të kanalizimit fekal dhe një rrjet të kanalizimit atmosferik.



2.2 Pasojat

- Problemet mjedisore dhe sanitare të derdhjes së ujerave të zeza të pa trajtuara,
- Problemi sanitar i mbledhjes dhe largimit të pamjaftueshëm dhe joadekuat të ujërave të zeza,
- Përmbytjet e shpeshta në disa pjesë të qytetit.

2.3 Kanalizimi i ujërave të zeza – koncepti i zgjedhjes.

Projektet për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza janë ndarë në 2 nën-grupe:

a) Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza dhe
b) Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonat rurale

a) Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit të ujërave të zeza

Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të zeza është tejkaluar në kuptim të periudhës projektuese, meqënëse i njëjti është ndërtuar për periudhën projektuese deri në vitin 1990. Rrjedhimisht, dimensionet e tubacioneve të rrjetit janë joadekuate (të pamjaftueshme) për numrin aktual të popullatës së Istogut. Kjo ka për pasojë bllokimet e shpeshta të kolektorëve (pusetave) të kanalizimit dhe përmbytjet e rrugëve dhe pronave të qytetarëve.

Prandaj GP konsideron dhe rekomandon të bëhet modelimi hidraulik i rrjetit ekzistues që do të shërbente si bazë për ri-disejnimin e këtij rrjeti dhe hartimin e projektit zbatues që do të përmbushte nevojat e popullatës deri në vitin 2050.

Bazuar në konfiguracionin gjeografik të komunës së Istogut dhe në studimet për këtë çështje nga hartuesit të Planit Zhvillimor Komunal, na mundëson që sistemi i ujërave të kanalizimit të evuakohet (grumbullohet) me gravitet, ne i kemi katër zona (pellgje) të grumbullimit. Grumbullimi i tëresishëm i ujërave të zeza pothuaj i tërë venbanimeve të KK-Istog do të përfundonin në fshatin Zabllaq-Drejë ku parashihet trajtimi i tyre.


Ky është sipas GP prioritet i shkallës së I-ë sa i përketë rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe rekomandohet të finalizohet gjatë periudhës 2023-2028.

b) Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza

Zgjerimi rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonat urbane që aktualisht nuk janë të përfshira, e duke u bazuar në Planin Zhvillimor dhe Urban të Istogut është konstatuar nga GP si një prioritet i lartë dhe parakusht bazik për zhvillimin e Istogut.

Zona e Pare;

- Istog, Istog i Poashtem, Cercë, Lubozhdë, Mojstir, Syne, Dragolevc, Muzhevin, Llug, Prigod, Lukavc i Begut, Kovragë, Tomoc, Gurakoc.



Projekti I - do të përfshijë qyteti dhe dhjetë (10) fshatra të cilët kanë gjithsej: **23,252** banorë (**31000** banorë – viti **2041**). Gjatësia e rrjetit primar (kolektori) është **33 km**, ndërsa gjatësia e rrjetit sekondar është: 3**0 km**. Diametri do të jetë minimal Ø 200 mm , ndërsa maksimal Ø 1000 mm, (7 km, nga Gurrakoci deri në Zabllaq), **tab. 1.**

Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është **: 4,800,000.00 Euro**.


Afati kohorë për realizimin e pilot – projektit fillimi 2023 – 2028.

Tab. 1. - Projekti I – Koha e implementimit (2023 – 2028)

Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Istog	6756	10000			∑ = 4,800,000.00 €
2	Cerrcë	1860	2500			
3	Lubozhdë	1250	1600			
4	Mojstir	680	1000			
5	Syne	530	700			
6	Istog i Posh.	1550	2000			
7	Muzhevinë	1014	1300			
8	Lluga	887	1200			
9	Prigodë	712	1000			
10	Tomoc	2134	2800			
11	Llukavc i B.	940	1200			
12	Kovragë	1170	1600			
13	Gurrakoc	3769	5000			
-	Totali	23,252	31900	33000	30000	

Zona e Dyte;

- Syrigonë, Cerkolez, Padalishtë, Uçë, Zhakovë, Shushicë, Rakosh, Bollopojë, Veriq, Dubravë, Kovragë, Llukavc i Thatë.



Projekti II - **Koha e implementimit (2024 – 2029)** do të përfshijë dymbëdhjetë (12) fshatra të cilët kanë gjithsej: **15074** banorë (**21140** banor – **2041**). Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit) është: **28 km**, ndërsa e rrjetit sekondar është: **31 km**. Diametri do të jetë minimal Ø200 mm , ndërsa maksimal Ø 500 mm. **Tab.2.**
Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është **: 3,600,000.00 Euro**.


Tab. 2. - Projekti II – Koha e implementimit (2024 – 2029)

Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Suhogerrlë	620	900			∑ = 3,600,000.00 €
2	Corkolez	440	650			
3	Padalishtë	612	800			
4	Rakosh	1399	1700			
5	Shushicë	2110	2800			
6	Bollopoj	560	750			
7	Uçë	1653	2000			
8	Zhakovë	594	790			

9	Veriq	620	850			
10	kovragë	1170	1600			
11	Dubravë	1280	1900			
12	Llukavc i That	247	400			
13	Gurrakoc	3769	6000			
-	Totali	15,074	21140	28000	31000	

Zona e Tretë;

- Belicë, Kerninë,Tuçep,Veriq i Ri, Osojan, Polan, Kosh, Shalinovc, Drejë, Zallq, Zabllaq.



Projekti III – Faza e implementimit (2025 – 2030) do të përfshijë njëmbëdhjet (11) fshatra, të cilët kanë gjithsej **7200** banorë (**10700 –viti 2039**). Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit) është **22 km**, ndërsa e rrjetit sekondar është 1**4 km**. Diametri do të jetë minimal Ø200 mm , ndërsa maksimal Ø 400 mm. **Tab. 3.**
Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është **: 2,800,000.00 Euro**.


Tab. 3. - Projekti III – Koha e implementimit (2025 – 2030)

Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Belicë	170	210			∑ = 2,800,00 0.00 €
2	Kerrninë	510	800			
3	Tyçep	120	150			

4	Veriq i ri	220	260		
5	Osojan	260	400		
6	Polanë	90	110		
7	Kosh	240	300		
8	Shalnavicë	120	160		
9	Drejë	658	900		
10	Zallq	720	1100		
11	Zabllaq	632	900		
-	Totali	3,740	5,290	22000	14000

Zona e Katërt;

- Vrellë, Studenicë, Kaliqan, Oroberdë, Lubovë, Bajë, Dubovë e Vogël, Bajicë, Corollukë, Dobrushë, Kashicë, Prekallë, Saradran, Trubohovc.



Projekti IV – Koha e implementimit (2025 – 2030)- do të përfshijë katërmbëdhjet (14) fshatra të cilët kanë gjithsej: 19,362 **banorë- (26,450 banor – 2041)**. Gjatësia e rrjetit primar (kolektorit)

është **35 km**, ndërsa gjatësia e rrjetit sekondar është **22 km**. Diametri do të jetë minimal Ø 200 mm , ndërsa maksimal Ø 600 mm. Tab. 4.
Vlera financiare për realizimin e këtij pilot - projekti është **: 5,300,000.00 Euro**.

Tab. 4. - Projekti IV – Koha e implementimit (2025 – 2030)

Nr.	Lokacioni	Nr. i ban. (2011)	Nr. i ban. (2041)	Rrj.primar (m)	Rrj. sekondar (m)	Kostoja (€)
1	Vrellë	3921	5200			∑ = 5,300,000.00 €
2	Studenicë	1952	2500			
3	Kaliqan	1260	1800			
4	Orroberrë	1320	1850			
5	Lubovë	712	1000			
6	Banjë	1829	2600			
7	Dubovë e v.	442	650			
8	Baicë	904	1250			
9	Corrollukë	684	900			
10	Dobrushë	1550	2100			
11	Kashicë	732	1100			
12	Staradaran	2150	2900			
13	Trubuhovc	1260	1700			
14	Prekallë	646	900			
-	Totali	19,362	26,450	35000	22000	

2.4 Mos- funksionimet Kryesore

- Shumë pika derdhëse drejtëpërdrejtë (ose me trajtim të pjesëshëm) në lumin e Istogut,
- Mungesa e cilësisë të gypave dhe punimeve ndërtimore të ndërtuara para vitit 2000,
- Mungesa e konceptit të përgjithshëm zhvillimorë për kanalizim,
- Drenazhimi joadekuat i ujërave atmosferik,
- Mungesa e mirëmbajtjes (strukturat e drenazhimit te kanalizimit dhe ujërave atmosferike të bllokuara me materiale të ngurta),
- Kanalizime pjesërisht pa qasje,
- Nuk ka trajtim të ujërave të zeza.

2.5 Opcionet e Rrjetit të Kanalizimit

- Punimet e rehabilitimit të rrjetit të kanalizimit

- Verifikimi i kapacitetit hidraulik të rrjetit të kanalizimit (modelimi hidraulik),
- Vlerësimi i Punimeve Rehabilituese,

- Parallogaritë-Krahasimi i Opcioneve,
- Përmbledhja e Kostove Rehabilituese,
- Punimet e zgjerimit të rrjetit të kanalizimit.

2.6 Modelimi Hidraulik-Metodologjia

- Inçizimi gjeodezik i rrjetit primarë dhe rrjetit kryesor e sekondarë,
- Definimi i zonave ujëmbledhëse me konsiderim të hapësirave zgjeruese,
- Karakteristikat e zonave ujëmbledhëse: sipërfaqja, dendësia e popullsisë, koefiçienti i pjerrësisë, shkalla e mbulesës se sipërfaqes,.....,
- Shtjellimi i modelit,
- Modelimi i kompjuterizuar hidraulik.

2.7 Kostot e Planifikimit të Rehabilitimit dhe Zgjerimit të Rrjetit të Kanalizimit

Planifikimi për Kanalizim **FAZA II.**	Kosto e Investimeve (Euro)
Totali për Rehabilitim	2.200.000
Projekti I	4,800,000
Projekti II	3,600,000
Projekti III	2,800,000
Projekti IV	5,300,000
Totali për Zgjerimit	16.500.000
Investimet totale:	**18.700.000**
Inxhinieria 5%	900.000
Shpenzimet e paparapara 5%	900.000
Totali i Investimeve ne Kanalizim e Ujerave te Zeza, Komuna - Istog	**20.500.000**

3.0 Trajtimi i ujërave të zeza për qytetin e Istogut (Krahasimi teknik-ekonomik dhe mjedisor si dhe zgjedhja e Opsioneve)

- Situatat ekzistuese e rrjetit të kanalizimit
- Pjesët përbërëse të studimit.
  - Prioritetet e Planit zhvillimor
  - Konkluzionet e projektit.
- Përfitimet e Projektit.

3.1 Alternativat e Trajtimit të Ujërave Urbane

- Disa eksperienca me trajtimin e ujërave të zeza urbane, aktualisht në Kosovë.
- Vënia në zbatim me teknologjinë e lehtë të operimit (ekstensiv) të trajtimit në fazën e parë të zbatimit.
- Zgjedhje e teknologjisë së aprovuar dhe gjerësisht të përdorur.
- Synim në vazhdimësi në pajtim me kërkesat e BE.

3.2 Teknologjia e Impiantit të Trajtimit të Ujërave urbane,

Opsionet e Propozuara


Faza afatshkurtër – afatgjatë e zbatimit (2035)

- **Alternativa 1:** Pellgjet anaerobike të ndjekura nga laguna të ajrosura (kërkesa për tokë, 16 ha);
- **Alternativa 2:** Pellgjet anaerobike të ndjekura nga filtrat e me pikim (kërkesa për tokë, 11 ha);
- **Alternativa 3:** Trajtimi me llum aktiv dhe me ajrim të zgjatur (kërkesa për tokë, 6 ha);


Faza afatgjatë e zbatimit (2036)

- Trajtimi me llum aktiv, me tretje anaerobike të llumrave dhe largim të Azotit dhe Fosforit;


Alternativa 1: Pellgjet anaerobike të pasuara nga laguna të ajrosura (kërkesa për tokë, 20 ha,)




Alternativa 2: Pellgjet anaerobike të ndjekura nga filtrat e me pikim (kërkesa për tokë, 15 ha)




Alternativa 3: Trajtimi me llum aktiv dhe me ajrim të zgjatur (kërkesa për tokë, 9 ha)



Faza e zgjerimit në vitin 2036



Skema dhe foto për Alternativen 2.



Avantazhet e metodës trickling – filter (Alternativa 2)

- Kursim të energjisë.
- Volum të vogël.
- Sipërfaqe të vogël të tokës.
- Operim dhe mirëmbajtje të lehtë.

Parametrat e trajtimit të ujërave të zeza

Parametrat	Mg/l	Standarti
Ujrat e zeza të pa trajtuara BOD/SS Conc.	**200/200 mg/L**	
Ujrat e zaze të trajtuara BOD/SS Conc.	**24/30 mg/L**	**Standarti EU. 25/35 mg/L**
Popullsia	**70.500 banorë**	

Filtrat:



3.3 Konkluzionet për alternativën 2

- Është një projekt afatgjatë.
- Me shpërndarje të shpenzimeve kapitale në një periudhë të gjatë kohe.
- Vlera e përgjithshme e buxhetit duhet të caktohet.
- Parashikimi për ndërtimin e tubacionit të linjave kryesore dhe sekondare, me kolektorë kryesorë, stacione pompimi dhe impiant pastrimi.

3.4 Përfitimet e projektit

- Përpunimi i ujërave nga banesat e amvisëritë.
- Uji i ndotur, pas përpunimit fillestarë dhe dytësorë del në parametrat e kërkuara nga BE.
- Përmirësimi i cilësisë së ujit të Lumit të Istogut e në rrjedhë më tutje të Drinit.
- Përmirësimi i kushteve sanitare në qytet dhe brigjet e lumenjëve.
- Zvogëlimi i rrezikut të sëmundjeve dhe pasurimin e shëndetit njerëzor.
- Përmirësimi i imazhit të qytetit të Istogut.

Kosto e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza

Përshkrimi	Njësia	Opcioni 2 ITUZ-2
Kapaciteti	p. e	70.500
Kostot Investive ITUZ	€	8.000.000
Kolektorët kryesorë	€	325.000
Investimeve	**€**	**8.325.000**
Inxhinierinë 5%	€	416.250
Shpenzimet e paparapara 3%	€	249.750
Totali i Investimeve për ITUZ	**€**	**8.991.000**
Kostot Specifike të Investimit	€ / p.e	**~125**

I. Infrastruktura e ujit të pijshëm

II. Infrastruktura e kanalizimit fekal

III. Trajtimi i ujërave të kanalizimeve urbane dhe rurale, Istog

Pjesët	Përshkrimi	Çmimi (€)
I	**Pjesa e Parë – Infrastruktura e Ujit të Pijshëm.**	**2.270.000**
II	**Pjesa e Dytë – Infrastruktura e Kanalizimit fekal.**	**20.500.000**
III	**Pjesa e Trete – Trajtimit të Ujerave të Kanalizimeve Urbane.**	**8.991.000**
Totali i Investimeve në Infrastrukturën e Ujit Kanalizimit dhe Trajtimit.		**31.761.000**

Totali për Infrastrukturën e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve është **31.761.000 Euro**, me një kosto specifike prej ~350 € / p.e (me kalkulim për 81.000 banor)

4.0 Konkluzione dhe Rekomandime

Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Istogut është joadekuate si në kuptimin e cilësisë së saj po ashtu edhe në kuptimin e shtrirjes së pamjaftueshme të saj. Kjo situatë ka për pasojë shërbime jocilësore të popullatës me shërbimet vitale siç janë furnizimi me ujë dhe shërbimet e kanalizimit. Për më tepër një infrastrukturë e këtillë joadekuate dhe në rastin e kanalizimit të ujërave të shiut dhe impiantit të ujërave të zeza, mungesa e plotë e infrastrukturës ka pasoja mjedisore dhe sigurisht që paraqet pengesë për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës.

Ndikimet negative në ujëra janë kryesisht nga derdhjet e kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat nuk janë të trajtuara paraprakisht. Me planin e ri parashihet integrimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe ndarja e kanalizimit atmosferik, i cili mund të derdhet në lumenj. Po ashtu është paraparë ndërtimi i një impianti kryesor apo si alternativë – Impiant lokal, apo si nënstacion, para lidhjes së impiantit kryesor që parashihet të ndërtohet në Komunën e Pejës, varesisht në koordinim mes dy komunave, si dhe politikave institucionale, në këtë rast me Ministrin e Planifikimit Hapsinor dhe Mjedisit (MPHM).

Përveç eliminimit të ndotjes me mbeturina të shtretërve të lumenjëve, masat për mbrojtjen nga vërshimet kanë paraparë parandalimin e ndikimeve negative të rritjes së sasisë së ujit nëpër lumenjtë dhe përroskat e komunës së Istogut.

Komuna duhet të hartojë dhe nënshkruajë një marrëveshje mirëkuptimi me prodhuesit e peshkut, pasi që ujërat nga hurdhat derdhen në lumenj dhe ujërat e tilla ndotin ujin e lumenjëve. Matja e rregullt e sasisë së ndotjës do të mundësojë veprimet adekuate. Po ashtu komuna duhët t'i obligojë këta prodhues që ta mirëmbajnë sasinë e ujërave në kanalet e ujitjes prej nga furnizohen me ujë hurdhat e peshqve, për të mos e cënuar ujitjen e arave që është komponentë esenciale e prodhimtarisë së suksesshme bujqësore.

Prandaj është e nevojshme që institucionet përgjegjëse (Komuna e Istogut dhe KRU "Hidrodrini") të harmonizojnë veprimet e veta për planifikimin dhe për shqyrtimin e formave dhe mundësive për financimin e investimeve të cilat janë identifikuar dhe përpunuar me këtë dokument dhe të cilat GP i konsideron të domosdoshme për ndërtimin e një infrastrukture funksionale dhe cilësore të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Duke pasur parasyshë lartësinë e parallogaritur të investimeve në këtë infrastrukturë **31.761.000 Euro** dhe në anën tjetër kapacitetet financiare të limituara që ka Komuna dhe KRU "Hidrodrini", imponohet domosdoshmërisht eksplorimi i burimeve alternative të financinimit të këtyre investimeve (donatorët, grantet nga Qeveria, buxheti i Komunës, mjetet e KRU "Hidrodrini", vetkontributi i qytetarëve etj.).

Rekomandohet që prioritetizimi i investimeve specifike në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit i propozuar me këtë dokument të shërbejë si një orientim për institucionet përgjegjëse për të hartuar një plan dinamik të implementimit të projekteve të veçanta duke i marrë në konsideratë burimet potenciale të financimit.

Vlerësim: Këto projekte të rëndësishme do të ndikojnë në jetën e banorëve në të ardhmen e afërt, por mund të kontribuojnë edhe në zhvillimin e përgjithshëm të komunës. Andaj, është e nevojshme që komuna dhe KRU'' Hidrodrini'' Sh. A., të jetë e kyçur aktivisht në procesin e planifikimit dhe implementimit të projekteve.

Ky dokument është hartuar, ne bashkpunim me Grupin Punues (GP) te Komunës Istog në bashkëpunim me KRU''Hidrodrini''SH.A., si rezultat I vlerësimeve të gjendjes ekzistuese, hulumtimeve si dhe takimeve dhe punëtorive të njëpasnjëshme.

REFERENCAT

- Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban – Istog,
- Strategjia e Kosovës për mjedisin – MPHM,
- Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2010 – MPHM,
- Plani Hapësinor i Kosovës, Instituti për planifikim hapësinor MPHM,
- Të Dhenat e përgatitura nga KK Istog,
- Të Dhenat e përgatitura nga KRU''Hidrodrini"Sh.A.- Pejë.

2023

DRAFT-
STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

2023 - 2026

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Europian
IT	Teknologji e Informacionit
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAP	(ish-)Ministria e Administratës Publike
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MAPL	(ish-) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
ZIP	Zyra për Informim Publik
UNDP	United Nations Development Program
USAID	United States Agency for International Development
TEAM	Transparent, Effective and Accountable Municipalities

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 4
2. SFONDI 5
   2.1. Profili i komunës 5
   2.2. Administrata komunale 6
   2.3. Zyra për Informim Publik 6
   2.4. Korniza Ligjore 7
3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET 8
   3.1. Ueb faqja e komunës dhe platformat sociale 8
   3.2. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje 8
   3.3. Marrëdhëniet me mediat 9
   3.4. Komunikimi i brendshëm 9
   3.5. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë 9
   3.6. Promovimi dhe marketingu i Komunës 10
4. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM 10
5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT 11
   Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë 12
   Fuqizimi i mekanizmave për komunikim dhe promovim të imazhit 12
   Avancimi i praktikave te komunikimit të brendshëm në administratën komunale 12
6. KANALET E KOMUNIKIMIT 13
7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR 14
8. INTERVENIMET NË MEKANIZMAT E KOMUNIKIMIT 16
9. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI 18
10. BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2021 18
11. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË 19
12. SHTOJCAT
    Shtojca 1. Plani i Veprimit për Komunikim dhe Informim 2021
    Shtojca 2. Plani i Veprimit për Transparencë 2019-2023

1. HYRJE

Komuna e Istogut ka përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve, informimit publik dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizatat të shoqërisë civile dhe me audiencat të tjera brenda komunës, organet shtetërore e qeveritare, partnerët e donatorët ndërkombëtarë, trupin diplomatik, etj. Por, pavarësisht këtyre, komuna në të kaluarën nuk ka pasur një dokument strategjik dhe të strukturuar për organizimin dhe udhëheqjen e komunikimeve në kuadër të administratës komunale.

Vitin e kaluar Kuvendi Komunës ka miratuar R*egulloren komunale për transparencë* me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në *Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave*. Ky veprim është pasuar me hartimin e *Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2023-2026*, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë. Një vëmendje e veçantë viteve të fundit i është kushtuar edhe promovimit të aseteve zhvillimore të komunës dhe potencialit tonë si destinacion me vlera turistike duke marrë parasysh trashëgiminë natyrore, historike dhe kulturore. Të gjitha këto, përbëjnë një bazament solid për hartimin e një dokumenti strategjik të komunikimeve dhe informimit, të cilat janë përvijuar në këtë akt.

Kjo *Strategji për Komunikim dhe Informim 2023-2026* është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfituar nga përvojat e mëhershme në këtë drejtim, spektri i pasur i skenës mediatike me frekuenca lokale si dhe nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij dokumenti do të kërkohet një interesim proaktiv i të gjitha audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, *Strategjia për Komunikim dhe Informim 2023-2026* është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me aktorë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar si rrjedhojë e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyese.

2. SFONDI

2.1. Profili i komunës

Komuna e Istogut shtrihet në një sipërfaqe prej 454 km² dhe ka një popullsi prej rreth dyzet mijë banorësh. Komuna gjendet në një pozicion të mirë gjeografik për faktin se ka një lidhje të mirë me qendrat e mëdha tregtare. Shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit: në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në verilindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jugperëndim me komunën e Pejës.

Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga antikiteti. Të dhënat tregojnë se Istogu si vendbanim në vendin e sotëm, është formuar në shekujt e mesjetës. Gjatë kohës së sundimit të Turqisë, kazaja e Istogut i ka takuar Sanxhakut të Pejës, ku bënin pjesë edhe kazaja e Gjakovës, dhe kazatë e Beranës dhe Gucisë (Mal i Zi). Istogu ai qytet/qendër administrative daton nga 29 dhjetori i vitit 1978. Si i tillë, Istogu ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike. Objektet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të veçantë është: Manastiri i Gorioqit, ndërsa zona të mbrojtura janë Burimi i Istogut, Burimi i Vrellës dhe Uji Termal – Banjë.

Segmentet ekonomike më të zhvilluara në Komunën e Istogut janë bujqësia dhe blegtoria. Në zhvillimin ekonomik komunal, rol dominues ka qyteti i Istogut, sepse shumica e kapaciteteve ekonomike janë të përqendruara në qendër. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, potenciale të rëndësishme përbëjnë agro-ekonomia, burimet e ujit, turizmi malor, qendrat e shërimit dhe rehabilitimit dhe industria e përpunimit të drurit.

Istogu ka një ambient të pastër ekologjik, male të larta, ujëra të pijshëm, ujëra të nxehta minerale dhe klimë të këndshme që e bëjnë Istogun si destinacion të përshtatshëm për zhvillim të turizmit. Rajonet më të njohura të këtij masivi në territorin e Istogut janë: Mokna, Bjeshka e Thatë, Gurrat e Bardha, Lugu i Butë, Koreniku, Corrovoda, Bajshet, Jerebia, Radusha, etj. Pika të rëndësishme për t'u vizituar janë: Qendra termale në Banjë, bjeshkët mbi Kaliqan, Studenicë, Vrellë dhe Lubozhdë si dhe Mokna (1300 – 1800 m lartësi mbidetare) - një territor me vlera natyrore dhe estetike siç janë: peizazhi natyror, relievi, përbërja gjeologjike, klimatike dhe karakteristikat hidrografike, si dhe flora dhe fauna që paraqesin potencial për zhvillimin e turizmit. Territorin e Moknës e karakterizojnë liqenet malore glaciale (ku jeton kërmilli i maleve), burimet e shumta të ujit natyral (më i njohuri është ai që njihet si "Kroni i Shenjtë", në rrjedhën e të cilit jeton trofta e përroit), stanet e verës, flora dhe fauna e pasur, frutat e malit dhe bimët mjekuese, kullosat, kushtet e mira për gjueti, shpella e Gollostenës, Maja e Madhe, etj.

Materialet me vlera të trashëgimisë kulturore janë të shumta në Istog, ku përshihen 73 kulla të ndërtuara midis shekujve 18 dhe 20, mullinj të ndryshëm që dëshmojnë civilizim mesjetar (Mulliri i Grijave, 1520), objekte fetare (8 xhami, 3 mejtepe dhe 3 kisha ortodokse, një kështjellë guri otomane në Zallç), etj.. Objektet me vlera arkeologjike janë të shtrira përgjatë Bjeshkëve të Thata, ku dallohen reliket e një qyteti antik në Synë, pastaj varri ilir në Cerrcë, kisha paleokristiane e shekujve 4 dhe 5 në Studenicë, Ura e Vjetër në Zallq (1695, me 13 harqe).

2.2. Administrata komunale

Administrata komunale është e organizuar në 13 drejtori: *Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtoria e Inspekcionit, Drejtoria për Shëndetësi, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Buxhet dhe Financa* dhe *Drejtoria për Bujqësi.* Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: *Zyra Ligjore, Zyra për Informim Publik, Zyra për Integrime Evropiane, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Auditori i Brendshëm, Avokati Publik i Komunës, dhe Shërbimi për çështje teknike dhe protokollare.*

Synimi i Komunës së Istogut është që të fuqizojë qeverisjen lokale përmes përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve komunale dhe për ta bërë atë më efikase, të qëndrueshme dhe demokratike.

Kuvendi i Komunës së Istogut ka gjithsejtë 27 ulëse.

Misioni i Komunës:

Institucione funksionale, me staf profesional që respekton parimet e ndershmërisë, vetëdijes dhe përgjegjësisë, ofron shërbime cilësore për qytetarët në pajtim me standardet më të larta të qeverisjes së mirë të bazuara në parimet e transparencës dhe kulturës demokratike.

2.3. Zyra për Informim Publik

Zyra për Informim Publik (ZIP) në administratën komunale të Istogut përbëhet nga dy (2) zyrtare për informim dhe mbështetet nga zyra për teknologji të informacionit. Zyra për Informim Publik kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, ZIP koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit. Sektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Më tej, ZIP mirëmban ueb faqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

2.4. Korniza Ligjore

Hartimi i kësaj Strategji është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Istogut –përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Istogut dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215 - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuara nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha ueb-faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Viteve të fundit, Komuna e Istogut ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të zgjeroj kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informimin sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës.

3.1. Ueb faqja e komunës dhe platformat sociale

Funksionimi dhe administrimi i ueb faqeve të komunave është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ të MAP Nr. 01/2015 mbi ueb faqet e Institucioneve Publike. Në vitin 2018 është ndërmarrë një nismë për ri-dizajnimin e tyre, e cila kishte për qëllim integrimin e sistemit të intranetit në menaxhimin e ueb faqeve, e për rrjedhojë edhe avancimin e shërbimeve online, gjurmimin e statusit të aplikacioneve dhe transmetimin direkt të seancave të Kuvendit. Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rëndësi në ueb faqen e komunës.

Përveç ueb faqeve, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook me një numër të konsiderueshëm ndjekësish (rreth 7K), i cili në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitet e komunës dhe Kuvendit. Në këtë drejtim, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social.

3.2. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Vitin e kaluar, Kuvendi Komunës ka miratuar rregulloren mbi transparencën me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave. Ky veprim është pasuar me hartimin e *Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë* 2023-2026, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë.

3.3. Marrëdhëniet me mediat

Komuna e Istogut karakterizohet me një spektër të pasur të mediave, si tradicionale ashtu edhe të reja. Në territorin e komunës operojnë tre (3) televizione me frekuenca lokale: RTV Fontana, Istogu Channel dhe TV Podguri, të cilat përveç tjerash mbulojnë edhe ngjarjet dhe aktivitetet e komunës. Po ashtu, ekzistojnë edhe disa radio lokale ndër të cilat edhe Radio West dhe Radio Fontana. Mjaft aktive është edhe skena e mediave online, ndër të cilat veçohen Portal Istogu (8K), Istog City (11K), Istogu Portal (7.1K), Lajme nga Istogu (3.3K), Istogu Press, etj.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikat tashmë të njohura të komunikimit, profesionalizmin e stafit në Zyrën për Informim Publik si dhe marrëdhënie e shëndosha me mediat të ndërtuara ndër vite. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social dhe produksionit vizual (sidomos në promovim të aseteve zhvillimore të komunës).

3.4. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale është avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes kësaj Strategjie është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët *(komunikim nga lart-poshtë),* shkëmbime ndërsektoriale *(komunikim i tërthortë)* dhe do të promovojë një kulture organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit *(nga poshtë-lart).*

3.5. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna vazhdon të kultivojë një bashkëpunim të shëndoshë me organizatat e shoqërisë civile. Organizata joqeveritare vendore kanë një trajtim të veçantë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik. Për më tepër, OJQ-të vendore janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike, debateve publike dhe aktiviteteve që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve ne funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës ne sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve

kapitale. Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapacitete vetanake të komunës.

3.6. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Istogu është në mesin e pak komunave që njihet për potencialet e veta turistike, andaj komuna është e angazhuar në vazhdimësi që ti zhvillojë dhe promovoj sa me shumë asetet turistike, natyrore, kulturore dhe historike për qëllime të zhvillimit ekonomik lokal. Për më tepër, në komunë ekziston edhe Zyra e Turizmit në përbërjen e të cilës punon një zyrtarë.

Së fundmi, në qershor të vitit 2020, në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Europian në Kosovë dhe UNDP është publikuar broshura *"Istogu im i bukur - Tregime për trashëgiminë kulturore dhe natyrore",* e cila është e disponueshme në format elektronik dhe të shtypur. Praktika të tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, madje në një formë më të strukturuar, dhe për këtë arsye çështja e promovimit dhe marketingut të komunë do të jetë një aspekt që do të adresohet në viteve në vijim.

4. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM

Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe me kohë në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

Transparenca – Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtruar me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

Llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës, sidomos në çështjet që ndërlidhen me buxhetin, financat dhe shpenzimet e komunës.

Përgjegjshmëria – Komunikim i rregullt i autoriteteve komunale me qytetarët që siguron shkallë të lartë të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, sukseseve dhe dështimeve eventuale të komunës.

Gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi – nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me


synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Nga sa u tha më sipër, komuna e Istogut synon që në tre vitet pasuese të fuqizohet në një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve, të rrisë transparencën, të promovojë ndërveprimin me qytetarë dhe aktorë të tjerë, të promovojë me saktësi dhe korrektësi aktivitetet dhe të arriturat e veta, si dhe të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja. Arritja e këtij qëllimi kërkon një mekanizëm solid të komunikimit dhe mesazhe të qarta, të cilat promovojnë vlerat e punës në administratën komunale, inkurajojnë punën ekipore dhe nxisin idetë inovative. Së këndejmi, Komuna e Istogut ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

1. ***Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe ndërveprimit me qytetarë***
2. ***Fuqizimi i mekanizmave për komunikim dhe promovim të imazhit***
3. ***Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale***



Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje (përmes zbatimit të plotë të Planit të Transparencës 2023-2026); të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e mbështetësit tonë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Fuqizimi i mekanizmave për komunikim dhe promovim të imazhit

Fuqizimi i mekanizmave të komunikimit do të synohet përmes paraqitjeve të strukturuara mediale, zgjerimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Po ashtu, në vitin e dytë dhe të tretë të kësaj strategjie, Komuna do të angazhohet që të hartojë një strategji marketingu në mënyrë që të promovojë vlerat dhe asetet e saj turistike, kulturore dhe historike. Përmes strategjisë së marketingut të komunës do të synohet që të nxitet interesi i vizitorëve, por edhe i investitorëve të mundshëm në të ardhmen.

Avancimi i praktikave te komunikimit të brendshëm në administratën komunale

Një strategji efikase e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mbështetet fort në kontributin dhe rolin aktiv të të gjithë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këtë arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë. Komuna do të kryejë intervenimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve. Një gjë e tillë do të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët *(komunikim nga lart-poshtë),* shkëmbime ndërsektoriale *(komunikim i tërthortë)* dhe do të promovojë një kulture organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit *(nga poshtë-lart).*

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe kërkesat e kësaj strategjie, Komuna e Istogut do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar te publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Ueb faqja e Komunës https://kk.rks-gov.net/istog/ mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Vështirësitë e hasura pas ridizajnimit të faqes zyrtare të komunës po tejkalohen gradualisht dhe në muajt në vijim ajo duhet të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.

Mediat online dhe platformat e komunikimit social – Sektori për Marrëdhënie me Publikun (SMP) do të krijojë lista të konsoliduara për të gjitha audiencat, duke përfshirë edhe mediat tek të cilat synon që të përcjellë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna duhet të kërkojë për forma më efikase të komunikimit me to. Në momentin aktual, Komuna e Istogut është e pranishme në platformën sociale Facebook. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2021) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Mediat – janë një kanal i rëndësishëm i komunikimit me publikun dhe audienca të tjera dhe Komuna në vazhdimësi është përpjekur të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me përfaqësuesit e tyre. Mungesa e televizioneve dhe radiove lokale është një hapësirë e cila duhet plotësuar me paraqitje më të strukturuara në mediat me frekuenca kombëtare.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime joformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërlidhen me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet dhe standardizohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara.

Videot dhe fotografitë - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pashoqëruar me narracion, ka

aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke zgjuar interesim dhe përfshirje emocionale.

Format inovative të takimeve komunitare – janë një mënyrë e mirë për të rrëzuar barrierat e komunikimit që ndërtohen në nivel komunitar si pasojë e qasjes së munguar në informacion.

Takime të strukturuara dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Komunikimet ndërinstitucionale - Institucionet dhe agjencitë e specializuara shtetërore *(ministritë relevante të linjës, agjencitë e pavarura shtetërore, institucionet dhe organizatat rajonale, etj.)* janë audienca që kërkojnë një trajtim të klasifikuar për shkak se ndërlidhen shumë me kompetencat dhe fushëveprimtarinë e komunës. Komunikimi me audienca të tilla në të shumtën e rasteve është i natyrave këshilluese dhe koordinuese me synim parësor që të evitohen mospërputhjet, veprimet joligjore apo shkeljet procedurale, e për rrjedhojë edhe rritjen e efikasitetit në punë përmes një qasje më proaktive.

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Istogut kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e duhura dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit. Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe drejtpërdrejta.

AUDIENCAT	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Personeli i administratës komunale	• Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten që të provojnë që gjërat t'i bëjnë më ndryshe dhe më mirë; • Administrata komunale është një ambient ku meritorët vlerësohen dhe shpërblehen. • Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia për të zhvilluar kapacitetet profesionale	• Ta dalin me propozime për përmirësimin e mekanizmave të brendshëm dhe rritjen e cilësisë së performancës • Të kenë mirëkuptim dhe ta respektojnë sistemin e vlerësimit të performancës brenda administratës. • Të ndjehen të lirë që të shfrytëzojnë mundësitë për ndërtimin e kapaciteteve profesionale në përputhje me mundësitë e komunës.

Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive	• Komuna e Istogut është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje. • Investimet kapitale në komunë planifikohen me pjesëmarrjen tuaj. • Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve.	• Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë. • Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor. • Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe kontributet e donatorëve dhe partnerëve.
